

# MËSIMI NË DISTANCË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SFIDAT DHE HAPAT E ARDHSHME



*Citizens for change!*



Projekti është mbështetur nga  
Bashkimi Evropian



| *Citizens for change!*



QENDRA PËR  
MENAXHIM ME  
NDRYSHIME

Projekti është mbështetur nga  
Bashkimi Evropian

Ky hulumtim u krye në kuadër të programit të punës "Ofrim më i Mirë i Shërbimeve Publike për Qytetarët, me përfshirje aktive të Kuvendit", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i bashkëfinancuar nga programi Civica Mobilitas.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Civica Mobilitas.

# MËSIMI NË DISTANCË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SFIDAT DHE HAPAT E ARDHSHME



*Citizens for change!*



QENDRA PËR  
MENAXHIM ME  
NDRYSHIME

Projekti është mbështetur nga  
Bashkimi Evropian

**Botues:** Qendra për menaxhim me ndryshime

**Për botuesin:** Neda Maleska-Saçmaroska, Qendra për menaxhim me ndryshime

**Autor:** Natalija Shikova

**Bashkëpunëtor profesionist:** Iskra Belcheva-Ristovska

**Redaktorë:** Neda Maleska- Saçmaroska

**Përkthimi:** Vjosa Taipi

**Lektura:** Marija Angelova

**Dizajni dhe shtypi:** Evropa 92

**Tirazh:** 100 ekzemplarë (tirazh pa pagesë/jo komercial)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37.018.43:[616.98:578.834(497.7)"2020"(047.31)

**SHIKOVA, Natalija**

Mësimi në distancë në Republikën e Maqedonisë së Veriut : sfidat dhe hapat e ardhshme / [autor Natalija Shikova]. - Shkup : Qendra për menaxhim me ndryshime, 2020. - 57 стр. : илустр. ; 25 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4818-75-5

а) Образование на далечина -- Коронавирус -- Македонија -- 2020 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 52258821

# СОДРЖИНА

<b>1. HYRJE</b> .....	1
<b>2. KORNIZA JURIDIKE PËR ZBATIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT</b> .....	4
Shkolla fillore .....	5
Arsimi i mesëm .....	6
Arsimi i lartë .....	7
<b>3. NJOHURI PËR KRYERJEN E MËSIMIT NË DISTANCË</b> .....	9
QËNDRIMET E PRINDËRVE TË NXËNËSVE .....	9
Metodologjia dhe të dhënat demografike .....	9
Parakushtet teknike për të ndjekur mësimet .....	11
Ndihma gjatë mësimet .....	12
Kënaqësia dhe sfidat gjatë mësimet në distancë .....	13
QËNDRIMET E MËSUESVE .....	16
<b>ANALIZË KRAHASUESE</b> .....	23
Për mësimdhënësit .....	27
Për prindërit .....	33
<b>MBRETËRIA E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE</b> .....	34
Për prindërit .....	36
Për mësimdhënësit .....	39
<b>REPUBLIKA E IRLANDËS</b> .....	42
<b>5. KONKLUSIONE</b> .....	50
<b>REKOMANDIME</b> .....	53



## 1. HYRJE

Covid-19 solli një realitet të ri në nivel botëror. Në përpjekjen për tu ballafaquar me të ashtuquajturin "armik të padukshëm", qasja e vendeve është e ndryshme, por në goditjen e përgjithshme të papritur mbi ekonominë, arsimit është një nga sektorët më të prekur. Për të parandaluar përhapjen e pandemisë, shumica e qeverive në të gjithë botën i kanë mbyllur përkohësisht institucionet arsimore në të gjitha nivelet. Pasojat nga ndërprerja e detyruar e mësimi janë të gjera dhe kjo masë ka prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë 60% të popullsisë botërore, pra atë që përfshin procesi arsimor.<sup>1</sup>

Kalimi nga klasa në mësim online nuk është aspak një detyrë e lehtë, sepse përveç infrastrukturës adekuate teknike dhe një niveli të caktuar të njohurive të aftësive digjitale, zbatimi i procesit i të mësuarit kërkon mbështetje të madhe nga familja. Kjo situatë krijoi një stres ekstrem jo vetëm për mësuesit, të cilët janë të shtyrë në një detyrë të re të papritur, por edhe për nxënësit sepse ata duhet të zëvendësojnë aktivitetet e përditshme shkollore dhe mënyrën e shoqërimit me detyrat mësimore të marra online. Sigurisht, shumë prindër e gjejnë veten nën presion të jashtëzakonshëm në përpjekjen për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të përshtaten me ndryshimet sa më shpejt dhe pa dhimbje që është e mundur.

Aspak nuk është e lehtë, mësimi online kërkon energji dhe kreativitet të jashtëzakonshëm organizativ që duhet të jetë në një nivel të lartë për ta tërhequr vëmendjen e nxënësve (në shumë raste, madje edhe me arsim digjital më të madh nga mësuesit e tyre). Siç pritej, aspektet mësimi online janë të ndryshme për nxënësit e niveleve të ndryshme arsimore, sepse, mbi të gjitha, niveli i pavarësisë së tyre në ndjekjen e orës së mësimi online është i ndryshëm.


Për më tepër, bllokada e përgjithshme sociale bëri që teknologjia në procesin arsimor të konsiderohet kusht pa të cilin është e pamundur, përkatësisht nuk perceptohet si luks më vete. Shpesh, sidomos në shtetet më të varfra, bazohet në supozimin se që të gjithë nxënësit dhe mësuesit kanë qasje individuale në internet të shpejtë dhe një kompjuter të azhurnuar siç duhet, ndërsa realiteti është se ka familje që mbështeten vetëm në një telefon të mençur. Në fakt, qasja në internet është një nga problemet kryesore, prandaj,

<sup>1</sup> <https://en.unesco.org/covid19/educationresponse/>

në këtë krizë, preken më shumë nxënësit nga familjet më të varfra, të cilët humbasin në mënyrë të pakrahasueshme më shumë nga klasat gjatë javëve jashtë shkollës, krahasuar me moshatarët e tyre që kanë një pozicion më të mirë shoqëror. "Boshllëku digjital" ekziston dhe duhet të adresohet në mënyrë të përshtatshme, kështu që shumë vende në të gjithë botën po vendosin programe arsimore falas në televizion për të arritur tek ata që nuk janë të lidhur në internet.

Situata aktuale tregon se nuk ka një qasje të unifikuar shtetërore për ta trajtuar këtë sfidë globale. Në mënyrë organizative, shumë gjëra varen nga infrastruktura e paracaktuar për kryerjen e mësimi online, struktura e TI-së, aftësitë dhe digjitalizimi i procesit arsimor. Politikat kombëtare varen gjithashtu nga modelet arsimore të zbatuara, reagimi ndaj krizës është i ndryshëm midis atyre vendeve që kanë sistem arsimor të centralizuar, krahasuar me ato ku shkollat gëzojnë autonomi më të madhe në krijimin dhe zbatimin e mësimdhënies.

### Foto nr.1 Qasje kombëtare ndaj sfidës globale të pandemisë



### Burimi UNESCO

Meqenëse është duke u bërë gjithnjë e më e qartë se sfidat organizative rreth procesit arsimor do të zgjasin për një periudhë më të gjatë kohore, është e nevojshme të jemi të gatshëm për t'u përballuar me to, të krijojmë zbatimin e qasjes më të përshtatshme sipas modelit ekzistues, arsimor të brendshëm. Në përpjekje për të kontribuar në krijimin e masave që do t'i adresonin sfidat, ne kemi përgatitur këtë analizë se si u zbatua mësimi në distancë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me cilat sfida përballemi dhe cilat janë hapat e ardhshëm që i propozojmë të zbatohen.



Analiza përbëhet nga disa segmente. Ajo përmban:

1. Analizë të kornizës ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për kryerjen e mësimit në distancë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të pandemisë me Covid-19.
2. Gjetjet e fituara në bazë të sondazhit me prindërit e fëmijëve në procesin arsimor me qëllim që të merren pikëpamjet dhe mendimet e tyre<sup>2</sup>.
3. Gjetjet dhe përgjigjet nga mësuesit dhe personeli administrativ në shkollat fillore dhe të mesme për të dhënë pikëpamjet e tyre profesionale<sup>3</sup>, fokus grupe të personave të përfshirë drejtpërdrejt në mësimin në distancë.
4. Analiza krahasuese të përvojës së provuar efektive gjatë kryerjes së mësimit në distancë.

Analiza përfshin zbatimin e masave për mësimin në distancë në periudhën mars - qershor 2020. Ajo i përmbledh njohuritë dhe i përgjithëson ato në mënyrë që të nxjerrim mësim të vlefshme dhe të zbatueshme prej tyre, por gjithashtu përmban rekomandime specifike që adresojnë drejtpërdrejt të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në procesin e arsimit në shtetin tonë. Qëllimi kryesor është të kontribuojë në krijimin dhe zbatimin e qasje të përshtatshme për zhvillimin efikas të procesit arsimor në të ardhmen, nëse për shkak të kësaj apo një situatë të ngjashme krize duhet të realizohet si mësimit në distancë, por edhe modernizimi i arsimit në atë drejtim, me qëllim që t'i përgjigjet sfidave të kohëve moderne.

<sup>2</sup> Anketa u realizua në korrik të vitit 2020 në ekzemplar prej 700 persona nga e gjithë popullsia e vendit, nga të cilët 300 ishin prindër të fëmijëve në procesin arsimor dhe mundën t'i përgjigjeshin anketës.

<sup>3</sup> Hulumtimi u krye në qershor dhe korrik të vitit 2020 mbi rreth 300 mësues dhe staf administrativ nga 33 shkolla në të gjithë vendin.

## 2. KORNIZA JURIDIKE PËR ZBATIMIN E MËSIMIT NË DISTANÇË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Arsimi në Republikën e Maqedonisë Veriore rregullohet nga tre ligje sistemore: Ligji për arsimin fillor, Ligji për arsimin e mesëm dhe Ligji për arsimin e lartë.<sup>4</sup> Për më tepër, në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm ekziston Ligji për arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme,<sup>5</sup> si dhe një sërë aktesh nënligjore (rregullore, udhëzime, etj., siç janë: Rregullorja për Mënyrën dhe Vëllimin e Detyrave të Punës brenda orëve të punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional gjatë javës së punës 40 orë; Rregullorja për Organizimin dhe Mënyrën e Realizimit të Mësimit Shtesë dhe Plotësues në Shkollat Fillore, etj.). Kjo kornizë ligjore nuk parashikon mësim në distancë, përkatësisht, nuk e njih atë si model të vlefshëm të të mësuarit.

Pandemia me Covid-19 sot është një realitet i ri, kështu që ky boshllëk ligjor u adresua me dekrete me fuqi ligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë një gjendje të jashtëzakonshme.

Qëllimi i urdhëresave është të kapërcejnë mangësitë e zbuluara të sistemit arsimor kombëtar, ato paraqesin përpjekje për t'iu përgjigjur sfidave aktuale. Në një situatë pandemie dhe ndërprerjeje fizike të mësimdhënies, tre nga urdhëresat qeveritare iu referuan arsimit fillor, tre për arsimin e mesëm dhe katër për sferën e arsimit të lartë, por kryesisht mbulojnë aspektet teknike dhe shumë pak merren me rregullimin e procesit arsimor. Shumica e urdhëresave përqendrohen në aspektet administrative, siç janë

<sup>4</sup> Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare Nr. 161/2019), në dispozicion në: [http://www.mon.gov.mk/images/Zakon\\_za\\_osnovnoto\\_obrazovanie\\_br.\\_161-\\_2019.pdf](http://www.mon.gov.mk/images/Zakon_za_osnovnoto_obrazovanie_br._161-_2019.pdf); Ligji për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82 / 1999,29 / 2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30 / 2007, 49/2007, 81/2008, 92 / 2008,33 / 2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41 / 2014,116 / 2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/108) në dispozicion në: <http://mon.gov.mk/stored/document/zakon-za-sredno-obrazovanie-precisten.pdf>; Ligji për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare Nr. 82/2018), në dispozicion në: [http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON\\_VISOKOTO\\_OBRAZOVANIE-final.pdf](http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf)

<sup>5</sup> Ligji për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme (Gazeta Zyrtare Nr. 161/2019), në dispozicion në: [http://www.mon.gov.mk/images/Zakon\\_za\\_nastavnicite\\_i\\_str.sorab.\\_161-2019.pdf](http://www.mon.gov.mk/images/Zakon_za_nastavnicite_i_str.sorab._161-2019.pdf)

zgjatja e marrëdhënies së punës së mësuesve ose nëpunësve administrativ në shkolla, përzgjedhja e organeve drejtuese dhe ngjashëm, ndërkaq shumë pak tregojnë në një plan të zhvilluar për organizimin dhe zbatimin specifik të mësimit në distancë. Për më tepër, nuk ka rregullore, udhëzime ose drejtime të disponueshme për publikun për organizimin e mësimit në distancë, dhe as rregullore për vlerësim. Dokumenti i vetëm në atë drejtim është Protokollin për të vepruar në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat, pra në njësitë përbërëse të tyre gjatë mbajtjes së provimeve. Protokollin përcakton masat për dhënien e provimeve në mjediset e institucioneve të arsimit të lartë (publik dhe privat) për shkak të mbrojtjes nga Covid-19.<sup>6</sup> Sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, në ueb-faqen EDUINO (Platforma Kombëtare për Mësim e cila në kohën e përpilimit të kësaj analize nuk është plotësisht funksionale)<sup>7</sup> ka vetëm udhëzime se si të organizohen aktivitetet digjitale, të paraqitura përmes një video dy-minutëshe e realizuar nga Qendra e Maqedonisë për Edukim Qytetar. Ekzistojnë video udhëzime të caktuara dhe burime të hapura në ueb-faqen e destinuar për kuadrin arsimor, por ato janë të pakta dhe të pamjaftueshme dhe në përgjithësi u referohen programeve arsimore në gjuhën maqedonase.<sup>8</sup>

Në vazhdim të tekstit, paraqesim se si në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mësimi në distancë rregullohej në gjendjen aktuale të jashtëzakonshme të pandemisë. Synimi ynë është të vëmë në dukje boshllëqet në proces që në kohë sa më të shpejtë që është e mundur të mund të miratohen akte për ta ndryshuar dhe plotësuar kornizën ligjore ekzistuese për të gjitha nivelet e arsimit, me qëllimin përfundimtar të vendosjes dhe vazhdimësisë së mësimit cilësor në distancë.

## *Shkolla fillore*

Pas ndërprerjes së mësimdhënies, më 13 mars 2020 dhe pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, më 23 mars 2020, me Urdhëresë me fuqi ligji u përcaktua që mësimi të zhvillohet përmes mësimit në distancë, pra përmes mësimit në shtëpi, duke përdorur fonde për komunikim elektronik, i cili siguron realizimin e mësimdhënies pa praninë e përbashkët fizike të pjesëmarrësve në procesin mësimor, pra mjete që mundësojnë komunikim të ndërsjellë, të dyanshëm.

Si mjet i komunikimit elektronik, Urdhëresa parashikoi platforma me video konferenca, postë elektronike dhe sisteme të tjera elektronike të shkëmbimit të të dhënave dhe vendimi se cili prej këtyre modeleve do të përdorej i lihej secilës shkollë fillore veç e veç. Prandaj, shkollës iu dha mundësia për të zgjedhur nëse do të përdorë platforma video konferencë

<sup>6</sup> [http://www.mon.gov.mk/images/documents/protokoli/Protokol\\_visoko.pdf](http://www.mon.gov.mk/images/documents/protokoli/Protokol_visoko.pdf)

<sup>7</sup> <http://www.eduino.gov.mk/al/index.html>

<sup>8</sup> Platforma EDUINO synon të rritet në platformë kolektive në të cilën nxënësit, mësuesit dhe prindërit do të krijojnë, rishikojnë dhe publikojnë burime dhe materiale të reja, dhe në këtë mënyrë planifikohet në shtet të ndërtohet biblioteka e parë kombëtare e materialeve arsimore digjitale.

dhe nëse do të zhvillojë mësimdhënie të drejtpërdrejtë ose "mësimdhënia" do të bëhet përmes postës elektronike, përkatësisht nxënësit do të marrin detyra mësimore me postë elektronike ose mjete të tjera të komunikimit elektronik, pa u mbajtur orët mësimore në mënyrë reale. Urdhëresa përcakton që mësuesi mund ta vlerësojë studentin duke pyetur, testuar, por gjithashtu mund të përdorë forma të tjera të përcaktimit dhe vlerësimit të njohurive përmes mjeteve elektronike të komunikimit.

Urdhëresa me fuqi ligjore prej 23 Marsit 2020 ndryshohet me Urdhëresën e 5 Majit 2020, e cila, nga ana tjetër, parashikon ndryshime shtesë në Ligjin për Arsimin Fillor, por ndryshimet shtesë nuk kanë të bëjnë me procesin e mësimdhënies, por i referohen të tjerave, aspektet formale të procesit arsimor, siç janë tarifat e regjistrimit, regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë dhe ngjashëm. Me këtë Urdhëresë u zvogëluua numri i orëve të detyrueshme (180 të parashikuara në ligj), u vendos një prag i pranueshëm tolerance prej të paktën 160 deri në më së shumti 180 orë për mësimdhënie përmes mësimimit në distancë/ mësimimit nga shtëpia, duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit. Ndryshimet zbatohen vetëm për vitin akademik 2019/2020.

Urdhëresa e fundit me fuqi ligjore në lidhje me arsimin fillor dhe ndryshimet në ligjin përkatës, të datës 17 maj 2020, i referohet aspekteve administrative (zgjatja e marrëdhënieve të punës të mësuesve dhe kuadrit administrativ, etj.), ajo nuk rregullon çështje që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e mësimdhënies.<sup>9</sup>

## *Arsimi i mesëm*

Urdhëresa me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të mesëm u miratua më 23 mars, 2020 dhe ndjek të njëjtën logjikë të Urdhëresës me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsimin fillor. Urdhëresa përcakton se çfarë paraqet mjete të komunikimit elektronik dhe përcakton se si të vazhdohet procesi i mësimdhënies. Shkollave të mesme gjithashtu u jepet mundësia të zgjedhin mënyrën e vazhdimin të arsimit të tyre (ose duke përdorur një platformë elektronike ose komunikim elektronik), dhe Urdhëresa përcakton procesin e vlerësimit, të formuluar si në Urdhëresën e 13 Marsit 2020, për arsimin fillor.

Me Urdhëresën me fuqi ligjore nga 5 maj 2020 përcaktohet që fundi i vitit shkollor të jetë 10 qershori 2020, pra 19 maj 2020 për nxënësit nga vitet e fundit të arsimit të mesëm. Nxënësit nga vitet e fundit për vitin shkollor 2019/2020 lirohen nga dhënia e maturës shtetërore, maturës shkollore dhe provimeve përfundimtare dhe u lëshohet diploma për arsimin e mesëm të përfunduar (vetëm për vitin shkollor përkatës). Dispozitat e tjera të Urdhëresës janë administrative dhe i referohen strukturës organizative dhe menaxhimit të shkollave (funksionet e organeve drejtuese, mandatet e tyre, etj.). Gjithashtu, Urdhëresa

<sup>9</sup><http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/pravilnici-2/3161-uredba-so-zakonska-sila-za-primena-na-zakonot-za-osnovno-obrazovanie-za-vreme-na-vondredna-sostojba>

me fuqi ligjore nga 17 maj 2020 i referohet çështjeve administrative-teknike dhe nuk përmban dispozita që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënies.<sup>10</sup>

Urdhëresa me fuqi ligjore nga 17 qershori 2020 parashikon dhënien e mbështetjes financiare për blerjen e pajisjeve shkollore për nxënësit e regjistruar në shkollat e mesme publike, pra ndihma për nxënësit nga familjet me të ardhura të ulëta. Mbështetja përfshin mjete për nxënësit siç janë fletët e vizatimit, mjete për të shkruar, pajisje sportive, etj., por nuk mbulon teknologjinë e TIK (laptop, tablet, kompjuter, logjistikë IT), të nevojshme për mësimin në distancë. Kjo ndihmë është e njëhershme, mund të përdoret nga shtatori 2020 dhe është 3000 denarë. Duke pasur parasysh ato detaje, është e qartë se një ndihmë e tillë është e pamjaftueshme dhe e papërshtatshme për t'i përmbushur nevojat teknike të reja, tani themelore të procesit të mësimin elektronik. Me Urdhëresën, paraqitja për shfrytëzim të ndihmës financiare kryhet përmes platformës në internet të Ministrisë së Arsimit (për të cilët, madje është e nevojshme të kihet TI pajisje dhe aftësi minimale digjitale).<sup>11</sup>

### *Arsimi i lartë*

Me urdhëresën me fuqi ligjore prej 23 marsit 2020 përcaktohet se vazhdon mandati i organeve dhe trupave të instituteve të arsimit të lartë, institutet arsimore publike, si dhe rëndësia e akreditimeve ekzistuese, përkatësisht ri-akreditime të programeve studimore. Sistemi i mësimin në distancë përcaktohet si një mënyrë e kryerjes së mësimdhënies dhe si një kontrollim i njohurive përmes përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik, me anë të të cilit institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht institucioni shkencor publik, në mënyrë të pavarur zgjedh/përcakton se cilat mjete do t'i përdorë. Kjo Urdhëresë është më e detajuar se ato të mëparshmet të miratuara në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm (megjithëse universitetet gëzojnë autonomi ligjore për dallim nga shkollat fillore dhe të mesme) dhe thekson se provimet dhe kolokiumi do të mbahen duke përdorur mjete elektronike të komunikimit, me kusht që të sigurohen zgjidhje të përshtatshme teknike që mundësojnë identifikimin dhe kontrollimin e punës së studentëve gjatë provimit. Dispozitat e tjera kanë të bëjnë me mandatin e personave udhëheqës, punën e shërbimeve profesionale dhe afatet e vlefshmërisë së akreditimeve që vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në një vit nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme.

Urdhëresa me fuqi ligjore nga 5 maj 2020 përsëri rregullon procesin e akreditimit (vlefshmërinë e programeve dhe organeve ekzistuese), por gjithashtu përcakton kushtet për regjistrim, tani bazuar në diplomë për arsim të mesëm katërvjeçar të përfunduar, të

<sup>10</sup><http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/pravilnici-2/3166-uredba-so-zakonska-sila-za-primena-na-zakonot-za-srednoto-obrazovanie-za-vreme-na-vonredna-sostojba>

<sup>11</sup><http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/pravilnici-2/3297-uredba-so-zakonska-sila-za-dodeluvanje-na-finansiski-poddrshka-na-uchenici-zapishani-vo-javnite-sredni-uchilishta-za-kupuvanje-na-uchilishen-pribor-a-koi-se-od-semejni-domakjinstva-so-nizok-dohod-za-vreme-na-vonredna-sostojba>

finalizuar në vitin akademik 2019/2020 dhe në përputhje me Urdhëresën me fuqi ligjore nga 5 maj 2020 për zbatimin e Ligjit për Arsimin e Mesëm gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Urdhëresa me fuqi ligjore e 22 majit 2020 lejon dhënien e provimeve në mënyrë fizike nëse institucioni i arsimit të lartë siguron parandalimin e përhapjes së Covid-19 bazuar në protokollet e duhura për veprim. Urdhëresa madje lejon praninë fizike në klasa, praninë e shërbimeve profesionale, si dhe komunikimin e drejtpërdrejtë dhe dhënien e provimeve përfundimtare, por vetëm nëse respektohen protokollet dhe nëse sigurohet mbrojtja e nevojshme.

Urdhëresa e fundit me fuqi ligjore nga 5 qershori 2020 përcakton participimin e pagesës shkollore, për regjistrimin në studimet e doktoraturës dhe për akreditimin dhe ri-akreditimin e programeve të studimit të ciklit të tretë të studimeve, si dhe procedurat për zgjedhjen e organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë.<sup>12</sup>

<sup>12</sup><http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-24-06-34-40/pravilnici-2/3165-uredba-so-zakonska-sila-za-primena-na-zakonot-za-visoko-obrazovanie-za-vreme-na-vonredna-sostojba>

## 3. NJOHURI PËR KRYERJEN E MËSIMIT NË DISTANCË

### *QËNDRIMET E PRINDËRVE TË NXËNËSVE*

#### *Metodologjia dhe të dhënat demografike*

Për të marrë pikëpamje dhe mendime nga prindërit e fëmijëve të përfshirë me sistemin arsimor, u krye një sondazh telefonik në lidhje me zbatimin e mësimit në distancë, dmth, prindërve iu kërkua të vlerësonin cilësinë e tij, kënaqësinë me këtë lloj mësimi, sfidat me të cilat përballen gjatë realizimit të procesit kompleks, por edhe nëse janë gati për vitin e ri shkollor të ardhshëm. Sondazhi u krye në maqedonisht dhe shqip, në ekzemplar prej 700 të anketuarve, nga të cilët 300 të anketuar mundën tu përgjigjen pyetjeve sepse kanë nxënës ose student në familje, ndërkaq sondazhi u krye në të gjithë vendin. Shumica e të anketuarve (42%) ishin të moshës 40–49 vjeç; pjesa më e madhe e të anketuarve ishin burra (53%), kryesisht maqedonas (66.3% e të anketuarve ishin maqedonas, 25% shqiptarë dhe 8.7% të etnive të tjera). Gjysma e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e mesëm (55.7%), ndërsa një e katërta e tyre (24.7%) kishin përfunduar arsim të lartë ose universitar. Të anketuarit kryesisht punojnë në institucione private (40% e tyre), ndërsa një e katërta e tyre (25.7%) janë të punësuar në institucione publike. Pjesa dominuese e të anketuarve (62%) jeton në një mjedis urban, përkatësisht në rajonin e Shkupit (29.7%). Lidhur me statusin martesor, pothuajse të gjithë të anketuarit (93%) jetojnë në një bashkësi martesore dhe kanë fëmijë të përfshirë në sistemin arsimor. Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.5%) kanë fëmijë në shkollën fillore, një e treta (33.8%) kanë fëmijë në shkollën e mesme, dhe një përqindje më e vogël e fëmijëve të të anketuarve (17.7%) janë studentë.

Të dhënat u mblodhën në periudhën nga 1 deri më 10 korrik 2020.

## Mësimet

### Koha e kaluar në mësim


Sipas shumicës së prindërve, nxënësit/studentët kanë kaluar 1 deri në 3 orë në ditë duke përbushur detyrimet e tyre arsimore (51.3%). Një numër më i vogël i nxënësve/studentëve (sipas 29.7% e të anketuarve) i kanë kushtuar 3 deri në 5 orë në ditë mësimi. Numri i nxënësve që kaluan më shumë se 5 orë në shkollë është i vogël (6.3%), dhe sipas deklaratave të të anketuarve, rrallë, por prapë disa nga studentët (2%) i kanë kushtuar mësimi më shumë se 8 orë në ditë.

Brenda kësaj kategorie statistikore, sipas shpërndarjes sipas vendbanimeve, numri i nxënësve që vijuan mësimet për më shumë se 3 orë në ditë është dukshëm më i lartë në mesin e nxënësve nga zonat urbane, ndërsa nxënësit nga zonat rurale kryesisht ndiqnin mësimet nga 1 në 3 në orë në ditë.

Sidoqoftë, statistika e lartpërmendur, në fakt, tregon se perceptimi i prindërve të anketuar është i saktë në lidhje me kohën reale që shkollat/institucionet arsimore i kushtojnë organizimit praktik dhe zbatimit të mësimi në distancë. Përkatësisht, më shumë se gjysma e të anketuarve (55.3%) thonë se shkolla e fëmijëve të tyre në të vërtetë organizoi mësim në dy drejtime që zgjaste vetëm 1 ose 3 orë në ditë. Në një numër më të vogël të shkollave (19%), mësimi zgjati nga 3 deri në 5 orë në ditë, dhe numri (6.3%) i shkollave në të cilat nuk kishte fare mësim në distancë është i vogël (Tabela nr. 1)

#### Tabela nr. 1

Sa orë në ditë, shkolla organizoi online mësim (në dy drejtime me diskutim midis mësuesit dhe nxënësve)?




- Nuk ka aspak mësim në dy drejtime
- 1 deri në 3 orë
- më shumë se 3 deri në 5 orë
- më shumë se 5 deri në 7 orë
- më shumë se 7 orë
- nuk e di



Nga ana tjetër, mësimi në distancë në dy drejtime nuk ishte i organizuar në të gjitha lëndët arsimore. Sipas të anketuarve, kishte vetëm 1 ose më së shumti 3 subjekte (20.3%); në një të katërtën e rasteve mësimi zhvillohej në 3 ose 5 lëndë (24.7%); dhe një numër i vogël i rasteve (15.7%) kur mësimi në distancë ishte zhvilluar në 5 ose 7 lëndë. Megjithatë, kishte 3% të rasteve kur mësimi në distancë në dy drejtime nuk ishte i organizuar fare (tabela nr. 2).

### **Tabela nr. 2**

Për sa lëndë të ndryshme arsimore, ishte organizuar online mësimi (në dy drejtime)?



Në krahasim, numri i lëndëve për të cilat ishte organizuar mësimi në shkollat e mesme ishte më i lartë se ai në shkollat fillore. Konkretisht, për shembull, përqindja e shkollave të mesme në të cilat zhvillohej mësimi nga 7 ose më shumë lëndë është 25%, krahasuar me 15.7% në shkollat fillore.

### **Parakushtet teknike për të ndjekur mësimet**

Sipas përgjigjeve të të anketuarve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut fëmijët kishin mjete të përshtatshme teknike për kryerjen e mësimin në distancë. Kjo do të thotë, prindërit thonë se fëmijët në procesin arsimor kanë përdorur kompjuter (43.2%), tablet (39.7%), pajisje shtesë, etj., dhe vetëm një përqindje e vogël e fëmijëve (0.9%) nuk kanë përdorur asgjë, dmth, fare nuk kanë ndjekur mësimin në distancë. Në pjesën më të madhe, fëmijët kishin internet të mjaftueshëm në disponim, internet të pakufizuar (89%). Një pjesë e vogël e fëmijëve nuk kishin kushte adekuate për ta ndjekur mësimin në distancë, ata ose kishin internet të dobët (7%), ose nuk e kishin fare internet (3%), pra interneti i tyre ishte i kufizuar. Sipas qëndrimeve dhe mendimeve të të anketuarve, nxënësit kanë njohuri të duhura teknike për mësim të pandërprerë në distancë (93.7%).


Këto gjetje të anketës janë të ndryshme nga reagimet publike, kryesisht nga prindërit që u paraqitën gjatë realizimit të mësimdhënies nga marsi deri në qershor 2020, por edhe pas kësaj, që shumë nxënës nuk kanë mjete për pjesëmarrje të pa penguar në mësimdhënie. Nisma qytetare për furnizimin me kompjuter të grupeve të rrezikuara të nxënësve (p.sh., Dhuroni kompjuter) <https://www.facebook.com/donirajkompjuter/>), por përpjekjet e tilla janë të pamjaftueshme, megjithëse duhen mirëpritur. Nga ana tjetër, MASH nuk paraqiti publikisht numrin e pajisjeve të nevojshme ose internetit të nevojshëm për t'i përmbushur nevojat e mësuesve dhe nxënësve, në mënyrë që të ndihmojë të gjithë që munden dhe kanë dëshirë.

### Ndihma gjatë mësimit

Gjysma e prindërve të anketuar i kishin ndihmuar fëmijët e tyre gjatë mësimit. Nga ata që kishin ndihmuar, 65.2% kaluan 1 deri në 3 orë në ditë duke mësuar me fëmijë. Kjo përqindje është më e ulët për prindërit që kanë fëmijë në shkollat e mesme sesa për prindërit e anketuar që kanë fëmijë në shkollat fillore dhe më e ulëta për prindërit e anketuar që kanë fëmijë nxënës. Ekziston ndryshim prej 7.7% në lidhje me gjininë e të anketuarve, 46.8% e prindërve meshkuj u përgjigjën se ata i ndihmonin fëmijët, krahasuar me 54.5% të grave të anketuara.

#### Tabela nr.3

A ndiheni të gatshëm (teknikisht dhe profesionalisht në disa lëndë...) se mund t'i ndihmoni për këtë lloj mësimi?




Shumica e prindërve, 77% në total, ndiheshin të gatshëm (plotësisht dhe pjesërisht) për t'i ndihmuar fëmijët e tyre me mësimin në distancë dhe një e pesta (21.7%) e prindërve të anketuar nuk u ndien aspak të gatshëm për t'i ndihmuar fëmijët e tyre në këtë pjesë të procesit arsimor. Siç pritej, sa më lartë të jenë nxënësit në procesin arsimor, aq më e ulët është gatishmëria e prindërve për tu ofruar ndihmë në mësim.

### *Kënaqësia dhe sfidat gjatë mëimit në distancë*

Përkundër kohës së shkurtër të kaluar në mësim (shih më lartë - *Koha e kaluar në mësimdhënie*), vetëm 29% e prindërve janë pjesërisht të kënaqur ose plotësisht të kënaqur me procesin e mësimdhënies. Prindërit e tjerë-të anketuar janë ose plotësisht ose pjesërisht të kënaqur me procesin e kryerjes së mëimit në distancë, gjithsej 68.4% (Tabela nr.4. Të anketuarit nga rajoni i Pollogut janë më të kënaqurit, dhe të anketuarit nga rajoni i Pelagonisë janë më pak të kënaqurit (79.6% kundrejt 51.5%).

**Tabela nr. 4**

Sa jeni të kënaqur nga realizimi i online mëimit?



■ Krejtësisht i kënaqur ■ Pjesërisht i kënaqur ■ Pjesërisht i pakënaqur ■ Krejtësisht i pakënaqur ■ Nuk e di

Gjatë mëimit në distancë, të anketuarit u përballën me sfida të caktuara. Disa nga të anketuarit besojnë se një mangësi e dukshme e këtij lloji të procesit arsimor është organizimi i pamjaftueshëm, ata besojnë se Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet ta kishte strukturuar atë shumë më mirë dhe si pasojë, sipas tyre, mësuesit nuk kanë qenë të përgatitur sa duhet për të dhënë mësim nga distanca. Qëndrimi i të anketuarve është se ata, si prindër, kishin një barrë shtesë, të papritur për shkak të nevojës për të ndihmuar fëmijët e tyre në mësim dhe ata vetë ishin prekur nga situata. Disa nga prindërit vunë re se cilësia e mëimit në distancë ishte plotësisht e papërshtatshme, që materiali mësimor


ishite shumë i shkurtër dhe nxënësit nuk i kushtonin vëmendje të duhur mësimdhënies. Për më tepër, disa prej të anketuarve besojnë se vlerësimi ishte joreal, se notat janë më të larta në krahasim me njohuritë reale të nxënësve.

### *Drejt mësimin të ardhshëm*

Megjithëse, sipas të anketuarve, mësimdhënia në shkollë është shumë më e mirë sepse shprehet autoriteti dhe ekspertiza e mësuesve, ata megjithatë konsiderohen të gatshëm nëse në të ardhmen do të zhvillohej mësimi në distancë. Përveç kësaj, ata kryesisht besojnë se fëmijët e tyre janë të gatshëm për mësim në distancë dhe përqindja e gatishmërisë së perceptuar në këtë mënyrë rritet në proporcion me nivelin e arsimit. Përkatësisht, prindërit e fëmijëve të cilët janë nxënës, besojnë më shumë se prindërit e tjerë, se fëmijët e tyre janë të gatshëm për mësim në distancë (tabela nr.5), por edhe këto 66.2% nuk janë aspak të kënaqshme. Lidhur me informacionin për vitin e ardhshëm shkollor, përqindja më e madhe e të anketuarve (86.3%) u përgjigjën se nuk janë të informuar se si do të zhvillohet procesi arsimor.

#### ***Tabela nr. 5***

Sa janë të kënaqur prindërit nga procesi i mësimdhënies së kryer në periudhën mars - qershor 2020, sipas nivelit të arsimit në të cilin aktualisht është përfshirë fëmija i tyre (në%):




## Arsimi digjital

Njohuritë digjitale në vend, gatishmëria për të përdorur TIK në RMV matet nga disa tregues nga Enti Shtetëror për Statistika, nga të cilët mund të shohim më nga afër numrin e njerëzve (15-74 vjeç) që porositnin ose blinin produkte ose shërbime përmes internetit, si dhe sa përqind e tyre telefonuan përmes internetit/video thirrjeve të përdorura (përmes ueb kam). Përqindja totale pas treguesit të parë në 12 muajt e fundit është 35.9% për të gjitha grup moshat së bashku dhe pas treguesit të dytë 64.9%. Për shkak se në kontekstin arsimor, të dhënat për nxënësit dhe studentët janë të rëndësishme, nga numri i përgjithshëm i njerëzve që blenë produkte në internet, më pak se gjysma (45%) i përkasin grup moshës 15 deri 24 vjeç, pra ultësia e 16% e popullsisë së përgjithshme.

Për krahasim, aftësitë digjitale (të matura si një indeks kompleks në nivelin e BE-së) tashmë janë të lidhura me gatishmërinë për të kryer mësim në distancë në të gjithë BE-në (figura nr. 2) dhe ato nuk janë në nivelin e duhur, shumica e pjesëmarrësve në proces kanë shkathtësi të arsimit digjital "bazë" ose "më shumë se themelore".

### Foto nr. 2

#### Chart of the Day



The coronavirus pandemic has increased the need to work or study remotely and that's bad news for youngsters in Italy, where less than two-thirds of 16- to 24-year-olds have "basic" or "above basic" digital-literacy skills. Croatia, Estonia and The Netherlands lead the rest of the EU with rates above 90%, according to Eurostat data for last year. The lingering fear of a second virus outbreak is likely to exacerbate these inequalities.

Burimi, Bloomberg, 20 korrik 2020.

Përkthimi: "Grafikon na denot/Mladina so veshtini (Grafiku i ditës / Rinia me aftësi)

*Pandemia e Virusit Korona ka rritur nevojën për punë dhe mësim në distancë dhe ky është një lajm i keq për të rinjtë në Itali, ku më pak se 2/3 e të rinjve të moshës 16-24 vjeç kanë aftësi "themelore" ose "më shumë se themelore" në arsimin digjital. Kroacia, Estonia dhe Holanda kryesojnë në Bashkimin Evropian me mbi 90% të të rinjve me aftësi të tilla, sipas të dhënave të Eurostat për vitin e kaluar. "Frika nga një valë e dytë e infeksioneve të virusit mund t'i thellojë këto ndryshime."*

## QËNDRIMET E MËSUESVE

### Metodologji

Për nevojat e hulumtimit, u zhvilluan fokus grupe, intervista dhe pyetësorë dhe qëllimi kryesor ishte marrja e mendimeve të mësuesve dhe stafit të ngarkuar me çështjet administrative në shkollat fillore dhe të mesme, nga ata që ishin të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e mësimit në distancë. Hulumtimi u organizua në 33 shkolla, nga të cilat 17 fillore dhe 16 të mesme. Një e treta e tyre ishin në zonat rurale (në fshatra), dhe pjesa tjetër në zonat urbane nga komunat në rajonet veriore dhe lindore të vendit, përfshirë Shkupin, si kryeqytet. Një total prej rreth 300 mësuesish dhe staf administrativ morën pjesë në hulumtimin e opinionit të tyre.

Konkluzioni i përgjithshëm pas përmbledhjes së pikëpamjeve të siguruara përmes grupeve të fokusit është se nuk ka ndryshime të konsiderueshme në përgjigjet e mësuesve nga arsimit fillor dhe i mesëm, por ka disa ndryshime në përgjigjet e mësuesve që japin mësim në zonat urbane dhe rurale. Sidoqoftë, në përgjithësi, mund të konkludohet se opinionet e mësuesve që morën pjesë në fokus grupet në lidhje me mësimin në distancë, në pjesën më të madhe përputhen.

### Qëndrimet e mësuesve dhe stafit administrativ në shkollat

Shumica e mësuesve zhvilluan mësim në distancë vetëm në një lëndë dhe një numër i vogël i tyre në më shumë se një lëndë. Kjo është e pritshme kur bëhet fjalë për një mësues që jep një lëndë. Fatkeqësisht, sipas përgjigjeve të mësuesve, mësimi zakonisht zhvillohej duke shpërndarë materiale për nxënësit, me pritjen se ata do ta zotëronin vetë materialin mësimor, ndërsa shumë rrallë mësimi zhvillohej përmes "ligjëratave në distancë" dhe bisedave shtesë me nxënësit (si komunikim i dyanshëm). Ne konkludojmë se kjo nuk është në përputhje me Urdhëresën e miratuar me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsimin fillor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, e cila në nenin 2 në mënyrë të prerë, thotë se mësimdhënia duhet të realizohet përmes komunikimit të ndërsjellë të dyanshëm, përkatësisht në realitet komunikimi ishte kryesisht vetëm një kahëshe nga mësuesit drejt nxënësve.

Mësuesit që praktikuan mësimdhënien përdorën një larmi mjetesh, të tilla si ZOOM, KAHOOT, ekipet e Microsoft teams dhe ngjashëm. Me këto mjete, stafi mësimdhënës ishte në komunikim me nxënësit, por ata nuk mendojnë se një komunikim i tillë është në të njëjtin nivel me komunikimin me nxënësit kur ata janë në shkollë. Mësuesit shpesh përdorën rrjetet sociale si mjet komunikimi.

Personeli mësimdhënës ishte në komunikim me prindërit, por një komunikim i tillë zhvillohej vetëm kur ishte e nevojshme. Përrjashtim bën komunikimi me ata prindër, fëmijët e të cilëve ndjekin shkollën fillore, të cilëve iu duhej më shumë ndihmë në përvetësimin e materialit mësimor. Pikërisht përfshirja e prindërve në procesin arsimor, përkatësisht mbështetja e tyre ndaj fëmijëve, provokoi reagimet dhe pakënaqësitë më të mëdha në publik. Lidhur me domosdoshmërinë për përfshirjen e prindërve edhe vetë mësuesit theksojnë se është veçanërisht e vështirë të punosh me nxënës më të vegjël, përkatësisht për një mësimdhënie efektive, është i nevojshëm komunikimi i vazhdueshëm me ta.

Mjetet moderne elektronike mundësojnë komunikim të dyanshëm. Prandaj, mësuesit duhet të jenë të obliguar të realizojnë mësimdhënien përmes ekranit me praninë e njëkohshme të nxënësve, dhe jo duke dërguar detyra në mënyrë të njëanshme dhe duke prituri që prindërit të kenë rolin e mësuesve.

Sipas mësuesve, shumica e nxënësve ishin të motivuar, por motivi është zvogëluar me kalimin e kohës, dhe veçanërisht u zvogëluar në fund të vitit shkollor. Është interesante të theksohet se gjatë këtij lloji mësimi, në raste të caktuara, nxënësit më të dobët treguan interes më të madh dhe rezultate më të mira në raport me mësimin e zakonshëm, klasik.

Lidhur me vlerësimin, mësuesit i vlerësuan nxënësit në mënyrë përmbledhëse, online, përmes vlerësimit të detyrave të shtëpisë dhe përmes projekteve të caktuara mësimdhënëse. Mësuesit kanë realizuar teste elektronike, ndërsa kanë vlerësuar aktivitetin, dhe kanë marrë parasysh punën e mëparshme. Për disa lëndë nuk është realizuar mësimi në distancë, për shembull për muzikë ose edukim fizik, kështu që notat e fundit të nxënësve u morën parasysh gjatë vlerësimit. Sipas mësuesve, më komplekse për organizimin doli të ishte mësimdhënia praktike, siç për shembull për lëndët edukatë fizike, art dhe muzikë, por jo më pak komplekse ishte edhe realizimi i mësimin për shkencat natyrore si matematika, kimia dhe fizika, veçanërisht në rastet e detyrave të komplikuar, që ka qenë e vështirë të shpjegohet përmes platformave ekzistuese elektronike në dispozicion. Lënda - gjuhë angleze - gjithashtu provoi të jetë e vështirë për tu organizuar.

Shumica e mësuesve nuk kanë mbajtur statistikë për të gjithë procesin, përkatësisht nuk mund të kategorizojnë dhe vlerësojnë përvojat e tyre. Opinione janë të ndara nëse programet mësimore janë përshtatur në mënyrë të duhur për grup moshat e nxënësve dhe së këndejmi janë të ndara edhe mendimet për të ardhmen e mësimin në distancë. Sipas

mësuesve, është më e vështirë të punosh me grupin e nxënësve më të vegjël, pra fillestarët në procesin arsimor - nxënësit e klasave të para, pasuar nga nxënësit e klasave të ulëta (nga klasa e parë deri në të pestën), pastaj gjysmë maturantët. Gjithashtu është e vështirë të punosh me nxënësit e vitit të parë në shkollë të mesme.

Më e vështirë është të punosh në distancë me nxënës që janë në të ashtuquajturat "Periudha arsimore kalimtare":


- Nxënësit e klasës së parë
- Vitet e para të mësimin në grupin klasor
- Viti i parë i mësimdhënies lëndore (klasa e gjashtë)
- Viti i parë i arsimit të mesëm

Konkluzion i shumicës së mësuesve është se edhe nxënësit nuk janë ende plotësisht të përgatitur për mësimin në distancë, por që ata mund të përshtaten më shpejt me situatën e re.



Trendi i rritjes së përdorimit të Internet - mjeteve për qëllime arsimore është rritur në të gjitha vendet e Ballkanit, përfshirë Maqedoninë e Veriut, kështu që ne shpresojmë që kjo të kontribuojë në një adaptim më të shpejtë dhe më të mirë të mësimin në distancë (Tabela nr. 6).

**Tabela nr. 6**




Burimi: Barometri Ballkanik, Këshilli Rajonal për Bashkëpunim, qershor 2020<sup>13</sup>.

Para krizës së pandemisë Covid-19, pjesa më e madhe e mësuesve kurrë nuk kanë dhënë mësim në distancë, shumica e tyre nuk ishin të trajnuar për mësimin në distancë, kështu që gjatë krizës ata u lanë vetë dhe me aftësitë e tyre (Tabela nr.7). Për të kryer mësimin, një numër i vogël i mësuesve kanë përdorur platformën Eduino, të propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe shumica e tyre përdorën platformat sipas zgjedhjes së tyre, të tilla si ZOOM, KAHOO!, ekipi i Microsoft team, E-klasa dhe të ngjashme.

**Tabela nr. 7**

A është i trajnuar stafi mësimor për online mësim?




<sup>13</sup> Të dhënat janë në dispozicion në <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public>.

Mësuesit besojnë se jo të gjitha shkollat kanë mundësi t'u sigurojnë kuadrit mësimor kushte të kompatibile për mësimin në distancë, dhe madje edhe ato shkolla që e kishin atë mundësi, megjithatë, nuk jua kanë siguruar atë (Tabela nr. 8).

### Tabela nr. 8

A siguron institucioni juaj kushte të përshtatshme që stafi mësimdhënës të zhvillojë online mësim?



■ Po ■ Jo ■ Pjesërisht

Prandaj, shumica e mësuesve thonë se ata u lanë vetë, me kapacitetet e tyre teknike dhe mjetet dhe përvojat e tyre personale të komunikimit të ballafaqohen me gjendjen. Mësuesit gjithashtu theksojnë se shumica e shkollave nuk përfitojnë nga masa qeveritare - "Kompjuter për çdo fëmijë" sepse shumica e kompjuterëve janë ose me defekt ose të vjetërsuar.

Mangësitë më të dukshme / më të zakonshme me të cilat përballen mësuesit në realizimin e mësimin në distancë:

- motivim i pamjaftueshëm,
- aktivitete të parregullta,
- parregullsia e informatave kthyese,
- mungesa e komunikimit të drejtpërdrejtë me nxënësit,
- pavarësia në kryerjen e obligimeve të punës, dhe
- pamundësia për vlerësim objektiv.


Disavantazhet në parakushtet teknike për realizimin e suksesshëm të mësimdhënies:

- internet i pamjaftueshëm dhe lidhje e qëndrueshme,
- numri i pamjaftueshëm i kompjuterëve në shkolla,
- nxënës pa pajisje adekuate për të ndjekur mësimin,
- mungesa e mbështetjes teknike në proces,
- kushtet e përgjithshme shtëpiake për ndjekjen e mësimin në distancë.

Shumica e mësuesve mendojnë se Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk i ndihmoi sa duhet në realizimin e procesit mësimor, përkatësisht se mësuesit morën vetëm udhëzimet themelore për mësimin në distancë (Tabela nr. 9), më saktë, se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ngriti vetëm internet platformën e centralizuar dhe TV- platformën. Prandaj, ata konsiderojnë se mësimi nuk ishte mjaftueshëm adekuat. Jo vetëm që nuk ishin të përgatitur mësuesit, prindërit dhe nxënësit, por të anketuarit besojnë se as Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe as Byroja për Zhvillimin e Arsimit, as komunitatet, nuk ishin të përgatitura. Pa përgatitja ishte e natyrës teknike dhe organizative (p.sh. mosrespektimi i kushteve për realizimin e orëve, veçanërisht në rastin e familjeve ku ka më shumë fëmijë-nxënës, ndërsa ata kanë vetëm një pajisje ose një kompjuter për të ndjekur mësimin).

### Tabela nr.9

A ju ka ndihmuar Ministria e Arsimit dhe Shkencës në realizimin e procesit mësimor?



■ Po ■ Jo ■ Pjesërisht


Pikërisht sepse ata nuk kishin udhëzime të detajuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, disa nga mësuesit planifikojnë në mënyrë të pavarur vitin e ardhshëm shkollor,<sup>14</sup> ndërsa shumica e tyre nuk kanë informacion se si do të vazhdojë procesi mësimor, as nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, as në aspektin organizativ nga komunitatet ku ndodhen shkollat.

Mësuesit besojnë se cilësia e mësimdhënies nuk ishte mjaft e mirë, se domosdoshmërisht i nënshtrohej improvizimit dhe se nevojiten trajnime dhe protokolle të përshtatshme për të rritur cilësinë (Tabela nr.10). Prandaj, ata ndjehen vetëm pjesërisht të kënaqur me mënyrën se si është zhvilluar mësimi në distancë, ndërkaq edhe atë "kënaqësi të pjesshme", ja atribuojnë, si rezultat i aftësisë së tyre për t'u përshtatur me rrethanat të reja, në këtë rast, të papritura dhe kushtet e papërshtatshme të punës.

<sup>14</sup> Të dhëna nga korriku i vitit 2020 kur u krye hulumtimi.

**Tabela nr. 10**

Sa jeni të kënaqur me zbatimin e procesit mësimor në kushte të krizës shoqërore?



## ANALIZË KRAHASUESE

Në mënyrë që të fitojmë përvoja krahasuese në lidhje me atë se si është realizuar mësimi në distancë në vendet të tjera të Evropës, u realizua edhe analiza krahasuese. Republika e Kroacisë, Republika e Irlandës dhe Britania e Madhe janë marrë si shembuj ilustrues. Sigurisht, politikat e tyre arsimore janë vetëm pjesë e shumë përpjekjeve të vazhdueshme të sistemeve arsimore kombëtare në të gjithë botën,<sup>15</sup> por ato modele u zgjodhën posaçërisht për shkak të inovacionit të qasjes dhe për shkak të shfaqjes së një game të gjerë aspektesh jashtëzakonisht të rëndësishme në krijimin e një qasje koherente dhe gjithëpërfshirëse për mësimin në distancë. Meqenëse këto janë përvoja të ndryshme, secila e vlefshme në mënyrën e vet dhe e përshtatshme për rrethanat shoqërore dhe ekonomike të sistemit në të cilin është implementuar, ne bashkëngjijim një përmbledhje të detajuar të aspekteve më të dobishme.

<sup>15</sup> Një përmbledhje e detajuar e të gjitha sistemeve të mësimin në distancë mund të gjendet në faqen e mëposhtme të internetit <https://en.unesco.org/covid19/educationresponse/nationalresponses>



# REPUBLIKA E KROACISË

Kalimi në mësimin në distancë në sistemin arsimor të Republikës së Kroacisë për shkollat fillore dhe të mesme, dhe në fakt për arsimin e lartë, ndodhi brenda natës. Sidoqoftë, megjithëse vendimi i Qeverisë për të ndaluar mësimin në shkolla dhe institucione të arsimit të lartë u mor më 13 mars 2020, ai filloi të zbatohet që prej 16 marsit 2020. Dispozita themelore e vendimit të qeverisë ishte që mësimdhënia duhet të vazhdojë si mësim në distancë.

Për të arritur këtë qëllim kryesor për të gjitha institucionet arsimore, u sigurua mbështetje teknike në nivel kombëtar, që do të thotë krijimin e platformave të tilla si - mjedisi virtual i të mësuarit, por gjithashtu mbështetje në krijimin e përmbajtjes mësimore dhe udhëzimeve për organizimin e punës së mësuesve dhe nxënësve në procesin e mëimit në distancë.

„*Shkolla për jetën "(Škola za zivot)"*<sup>16</sup> është emri i një programi eksperimental që zbatohet përmes Ministrisë së Shkencës dhe Arsimit të Republikës së Kroacisë në 48 shkolla fillore dhe 26 shkolla të mesme. Në përgjithësi, programi përfshin nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën në shkollat fillore, ndërsa për klasën e pestë, organizohet mësim special për lëndët e biologjisë, kimisë dhe fizikës. Në të gjitha lëndët e arsimit të përgjithshëm, programi eksperimental zbatohet në mënyrë të barabartë në shkollën e parë të shkollës së mesme gjimnaz dhe në shkollën e parë të shkollave profesionale. Qëllimi kryesor arsimor është të testohet zbatueshmëria e programeve të reja mësimore, formave dhe metodave të punës, si dhe mjeteve të reja mësimore, kryesisht për të forcuar kapacitetin e nxënësve për të zgjidhur problemet, për të rritur gradualisht kënaqësinë e tyre me llojin e ri të mësimdhënies dhe të motivohen së bashku me mësuesit e tyre.

Projekti, i paraqitur nëpërmjet numrave, përfshiu 8419 nxënës, 81 klasa virtuale, 42724 pjesëmarrës në klasa virtuale, 386 tema arsimore, 424 orë trajnim për përdorimin e platformave, 151 vizita këshilluese, 73 takime me prindërit, 1092 orë online mësimdhënie, 927 formime profesionale. Logoja e projektit u krijua nga nxënësit e shkollës grafike, dhe projekti mbështetet nga Fondi Social Evropian. Projekti përfshin Agjencinë Kroate për Zhvillim dhe Arsim, Rrjetin Akademik Kroat, Qendrën Kombëtare për Vlerësimin e Jashtëm të Arsimit, Agjencinë e Bashkimit Evropian për Mobilitet dhe Programe dhe Agjencinë për

<sup>16</sup> <https://skolazazivot.hr/>

Arsim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve.<sup>17</sup> Projekti mbështetet gjithashtu nga operatori kombëtar celular Tele2, i cili u siguron nxënësve internet falas për përmbajtje arsimore gjatë mësimit në distancë, si dhe qasje falas në faqet e internetit me përmbajtje arsimore të shtëpive botuese që marrin pjesë në reformat arsimore.

“Shkollë për jetën” është ueb faqe jashtëzakonisht e mirë-organizuar dhe e dobishme që përmban të gjithë elementët e nevojshëm për mësimdhënie, si dhe për vlerësimin e nxënësve. Faqja është e pasur me përmbajtje të shumta arsimore, si dhe udhëzime për organizimin e mësimdhënies dhe vlerësimit gjatë mësimit në distancë. Siguron përmbledhje të platformave të ndryshme, duke treguar mënyrën se si funksionojnë dhe si mund të përdoren, ofron këshilla për mësuesit, këshilla për nxënësit, përmbajtje video për përdorimin e të gjitha mjeteve, video mësimore për shkollën fillore dhe të mesme në të gjitha lëndët, por edhe libra elektronikë, e- lektyra, të sistemuara dhe të organizuara në një mënyrë të thjeshtë për t’u përdorur.<sup>18</sup> Për më tepër, materialet janë në dispozicion për nxënësit me dëgjim të dëmtuar,<sup>19</sup> klasa virtuale,<sup>20</sup> si dhe shembuj të shumtë nga shkollat për mësimin në distancë të kryer me sukses.<sup>21</sup> Pjesë e këtij projekti është e ashtuquajtura “TV-klasa”, ku ueb faqja e saj ofron orar në cilat ditë dhe në cilën kohë zhvillohet përmbajtje e caktuar mësimore për klasat e arsimit fillor dhe të mesëm.<sup>22</sup>

Përveç kësaj, veçojmë elementet që i konsiderojmë më të dobishme.

<sup>17</sup> <https://skolazazivot.hr/o-projektu/projekt-u-brojkama/>

<sup>18</sup> <https://skolazazivot.hr/materijali/>

<sup>19</sup> <https://skolazazivot.hr/obrazovni-sadrzaji/metodicki-prirucnici/metodicki-prirucnici-za-osnovnu-skolu/>

<sup>20</sup> <https://skolazazivot.hr/virtualne-ucionice-za-sve/>

<sup>21</sup> <https://skolazazivot.hr/webinar-informatika-u-razrednoj-nastavi-iskustva-i-primjeri-iz-eksperimentalnih-skola/>

<sup>22</sup> <https://skolazazivot.hr/raspored/>



## Për mësimdhënësit

### *Organizimi i mësim*

Mësimi në distancë zhvillohet në rrethana të jashtëzakonshme gjatë çka duhet të përdoren të gjitha avantazhet e tij, dhe duhet të bëhet një përpjekje për të minimizuar një sërë disavantazhesh. Kjo mënyrë e të mësuarit, e cila pritet të jetë afatshkurtër, nuk duhet të jetë pengesë në kalimin në nivel më të lartë arsimor. Përkundrazi, përveç përvetësimit të njohurive dhe aftësive të reja, gjatë mësimit të përmbajtjes përkatëse arsimore, theksi duhet të vihet në mirëqenien e nxënësve dhe inkurajimin e të mësuarit të vazhdueshëm, sesa në vlerësimin e asaj që është mësuar.<sup>23</sup>

Kontakti i mësuesve me nxënësit dhe prindërit është i rëndësishëm për të krijuar një rreth besimi për të mësim, dhe në atë rreth të gjithë kanë rolin e vet. Mjedisi virtual i mësimit duhet të ketë strukturë të qartë dhe vlera të vendosura, të cilat, nga ana tjetër, përfshijnë respektimin e punës, përkatësisht zero tolerancë për sjelljen e papranueshme. Gjegjësisht, nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë ndaj vetvetes dhe dijeve të tyre. Përgjegjësia është gjithashtu e prindërve, kështu që ata duhet të sigurojnë nxënësit me mbështetje të vazhdueshme në procesin e zhvillimit të vetëdijes për sjelljen e përgjegjshme dhe konstruktive.

Duhet gjithashtu të theksohet se nxënësit kanë nevojë për një lloj mbështetje më të larmishme në klasën virtuale, sesa në klasat e rregullta. Duke punuar së bashku me bashkëpunëtorët profesionistë në shkollë, duhet të merren parasysh përshatjet specifike të nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe për nxënësit e talentuar.

Megjithëse disa shkolla mbajnë klasa virtuale në kohë reale, në mënyrë që të gjithë nxënësit të marrin pjesë në video konferencë në të njëjtën kohë, kjo metodë mësimore nuk rekomandohet sepse rëndon rrjetin dhe ngadalëson punën. Gjegjësisht, nuk është e nevojshme që nxënësit të identifikohen vizualisht, sepse të gjithë nxënësit dhe mësuesit kanë identitetin e tyre unik elektronik, i cili jep një avantazh të madh në organizimin dhe zbatimin e mësimit në distancë.

Duhet theksuar posaçërisht që përmbajtjet që mësuesit i ligjërojnë dhe vlerësojnë se duhet të përqendrohen në gjërat më të rëndësishme dhe duhet të lirohen nga detajet

<sup>23</sup> Nëse gjendja e jashtëzakonshme vazhdon, nevojiten ndryshime të ligjeve dhe akteve nënligjore të caktuara. Si paralajmërues i një situate të tillë, me qëllimin kryesor mundësimin e zbatimit të qëndrueshëm dhe sistematik të metodave të reja të vlerësimit, Ministria e Arsimit e Republikës së Kroacisë ndryshoi "Urdhëresën për metodat, procedurat dhe elementet për vlerësimin e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme".

dytësore ose të dhënat. Detajet dytësore ose të dhëna më pak të rëndësishme mund ta tërheqin vëmendjen e nxënësit nga ajo që është me të vërtetë e rëndësishme, përkatësisht ta ngarkojnë nxënësin pa nevojë në vend që ta lejojnë atë të kuptojë kontekstin më të gjerë arsimor.<sup>24</sup>

### *Vlerësimi / notimi*

Vlerësimi është një element themelor në procesin e reformave të programeve mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm, por është gjithashtu pjesë e të ashtuquajturës "Reforma e Bolonjës në arsimin e lartë". Të dy proceset e reformës e vendosin nxënësin në qendër të procesit shkollor, në mënyrë që mësimdhënia të mos përqendrohet aq shumë në përmbajtjen e ligjëruar, sesa në rezultatet e planifikuara arsimore. Nxënësi duhet të jetë aktiv dhe të mësojë përmes strategjive individuale dhe mënyrave të të mësuarit. Evaluimi i tillë depërton thellë në themelet e një sistemi të veçantë arsimor dhe është më i vështiri për tu ndryshuar në procesin e përgjithshëm të reformës. Nga ana tjetër, mënyra se si mësohet dhe vlerësohet duhet t'i udhëzojë nxënësit dhe studentët se si të mësojnë. Prandaj, me rëndësi jashtëzakonisht të madhe gjatë organizimit të mësimin në distancë ka vlerësimi rreth arritjeve të rezultateve të planifikuara nga mënyra e këtillë e mësimin.

Mjedisi virtual është një vend i shkëlqyeshëm për të mësuar, por gjatë vlerësimit të asaj që është mësuar, është e dëshirueshme të largoheni nga metodat tradicionale (standarde) të vlerësimit. Prandaj, rregullat që janë zbatuar deri më tani në shkolla, siç janë planet e testimit, caktimi i temave dhe datave, nuk duhet të zbatohen në mësimin në distancë, por është e nevojshme të rregulloni me kohë kornizën kohore për testet, përkatësisht provimet, ndërsa nxënësve tu jepen detyra më intensive për të balancuar ngarkesën e mësuesve dhe vëllimin e punës së nxënësve. Në të gjitha lëndët, si në klasë dhe në mësimin në distancë, aktiviteti i nxënësit mund të vlerësohet përmes diskutimeve dhe detyrave të shtëpisë.

Në ligjërimit normal / të zakonshëm në shkollë, nxënësit dhe mësuesit kanë komunikim në kohë reale, në mënyrë që mësuesi të mund të monitorojë dhe mbikëqyrë atë që është mësuar, pra të zbatojë të ashtuquajturin "Vlerësim përmbledhës". Pa investime shtesë, pa mjete të posaçme, që kërkon shumë kohë, e gjithë kjo nuk është lehtësisht e realizueshme në klasat virtuale. Nga ana tjetër, kjo lloj marrje në pyetje e kontrolluar shpesh rezulton me analizimin e fakteve dhe për realizimin e detyrave rutinë që nuk janë të përshtatshme për përvetësimin dhe përcaktimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të jetuar dhe punuar në shekullin 21. Nuk ka nevojë për kontroll të rreptë gjatë kryerjes së vlerësimit, as në klasën fizike dhe as në atë virtuale, sepse theksi vihet në reagimin cilësor të nxënësit, në atë se si të përmirësojë mësimin e tij / saj. Prandaj, në mjedisin virtual dhe në mësimin në

<sup>24</sup> Lidhja/linku përmban këshilla të hollësishme për mësuesit [https://www.youtube.com/playlist?list=PL9Mz0Kqh3YKr\\_5kBmR9FB4USHd0EwxIKk](https://www.youtube.com/playlist?list=PL9Mz0Kqh3YKr_5kBmR9FB4USHd0EwxIKk)

distancë, duhet të zbatohet një mënyrë e re e vlerësimit. Gjatë reformimit të mësimdhënies, të mësuarit dhe vlerësimi përqendrohen në atë – *si të mësojmë me sukses* – gjegjësisht: pse të mësuarit është i dobishëm, pse na pëlqen të mësojmë, pse duam të mësojmë se si të zgjidhim problemet, të mendojmë në mënyrë kritike dhe të punojmë në ekip. Kështu, ndryshimi duhet të jetë drejt niveleve më të larta kognitive që nuk mund të vlerësohen (vetëm) përmes testeve për njohuritë për një përmbajtje të caktuar. Mësuesit gjithashtu duhet të japin reagime individuale për nxënësit nëse nxënësi ka arritur rezultatet e pritura arsimore dhe si t'i përmirësojnë aftësitë e tij/saj të të nxënës. Për të arritur këtë, është e nevojshme të monitorohet puna e nxënësve, të inkurajohet aktiviteti dhe bashkëpunimi i tyre – si me mësuesin ashtu edhe me nxënës të tjerë.

### *Metodat dhe rekomandimet e vlerësimit - qasje standarde*

Metodat për vlerësimin e njohurive në shkollat në Republikën e Kroacisë janë ende kryesisht tradicionale, megjithëse është bërë përparim si rezultat i reformës së kurrikulës. Mësuesit nuk janë hasur kurrë në një gjendje të tillë të jashtëzakonshme, kështu që është e vështirë të ndryshosh shpejt mënyrën e mësimdhënies, modelin e mësimdhënies dhe është edhe më e vështirë të ndryshosh metodat e vlerësimit. Prandaj nuk është për t'u habitur që, edhe pse ekzistojnë metoda të reja, inovative të vlerësimit, shumica e mësuesve ende hezitojnë të fillojnë me to, duke preferuar t'u përmbahen disa prej metodave dhe procedurave ekzistuese, tradicionale të vlerësimit.

Metodat ekzistuese virtuale përfshijnë provime me gojë dhe me shkrim në kushte të kontrolluara. Ekziston një problem me besueshmërinë e përgjigjeve gjatë mësimit në distancë, sepse kryhet në mënyrë asinkrone. Metoda dhe mjete të caktuara mund të sigurojnë nivel të caktuar të besueshmërisë në testin e njohurive në distancë, dhe duhet të inkuorohen kur bëhet fjalë për provime me rëndësi të madhe (për shembull gjatë diplomimit). Për shkak se duhet kohë e caktuar, pajisje dhe trajnim për vendosjen e mjeteve të tilla në nivel kombëtar, për qëllimet e mësimit në distancë mund të vendosen metoda përkatëse, të caktuara për testimin e njohurive dhe shkathtësive mbi bazë të së cilave mund të vlerësohet nxënësi. Prandaj, është e nevojshme të zvogëlohet numri dhe vëllimi i testeve me gojë dhe me shkrim, dhe të përdoren detyra rutinore për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e moshatarëve / shokëve të klasës. Përdorimi dhe shpeshësia e këtyre metodave të provimit varet nga tema, njësia mësimore dhe veçanërisht nga qëllimi i dëshiruar arsimor.

Mënyra më e lehtë për të kryer vlerësim oral është përmes video konferencës. Rekomandohet që një provim i tillë të mos kryhet për çdo lëndë, sepse do të rëndojë pa nevojë mësuesit dhe nxënësit, si dhe sistemet e mësimit në distancë. Sidoqoftë, për lëndët e shkollës fillore dhe të mesme, ku orari i mësimdhënies parashikon tre ose katër

orë në javë, provimi me gojë duhet të realizohet një herë deri në fund të vitit shkollor, veçanërisht nëse mësuesi ose nxënësi dyshojnë në njohuritë e fituara ose nëse nuk ka elementë të mjaftueshëm për të përfunduar vlerësimin. Në rastet e tjera, mësuesi nuk ka pse të realizojë provim me gojë gjatë mësimit në distancë.

Në disa lëndë, si matematika, fizika dhe kimia, është e zakonshme që testi të bëhet me shkrim, sepse përfshin zgjidhjen dhe vlerësimin e problemeve. Mund të përdoren disa mjete, por edhe teknika e thjeshtë: "*Këto janë detyrat, ju lutemi zgjidhni ato në një kohë të caktuar, bëni fotografi të zgjidhjeve dhe dërgojini për kontroll*". Kjo teknikë e thjeshtë është gjithashtu e përshtatshme për nxënësit që jetojnë në vende me një lidhje më të dobët interneti. Nëse ekziston shqetësim për besueshmërinë e përgjigjeve, sepse ekziston dyshimi se nxënësi nuk i zgjidhi vetë detyrat, është e dobishme që mësuesit të njohin nxënësit e tyre dhe kështu, sipas të nxënit, praktikës dhe përparimit të tyre, ata do të jenë në gjendje të vlerësojnë nivelin e të nxënit. Pas testit me shkrim, i cili ndikon dukshëm në notë, është e dëshirueshme që të organizohet një intervistë / provim i shkurtër gojor në mënyrë që mësuesi të kalojë punën e tij me nxënësin dhe të sqarojë vështirësitë ose zgjidhjet e testit.

Në të gjitha metodat e vlerësimit, është e nevojshme të dallohen qartë përmbajtjet thelbësore nga ato më pak të rëndësishme, gjegjësisht nga ato dytësore. Përmbajtje të rëndësishme janë ato që mbështesin drejtpërdrejt realizimin e qëllimeve arsimore të programeve mësimore.<sup>25</sup>

Për më tepër, vetë-vlerësimi është i rëndësishëm. Roli i mësuesve në udhëzimin dhe monitorimin e nxënësve është vendimtar, veçanërisht në procesin e vetëvlerësimit. Gjegjësisht, duke pasur parasysh faktorin e subjektivitetit (i cili është një sfidë e vazhdueshme në këtë proces), roli i mësuesit është të ndjekë procesin, ta udhëheqë nxënësin dhe ta korrigjojë atë. Është e rëndësishme të theksohet se vetëvlerësimi i bën nxënësit më të motivuar dhe më të hapur për të mësuar, dhe prindërit duhet të përfshihen në të.

<sup>25</sup> Udhëzimet përkatëse përfshijnë vlerësimin e përgjithshëm, si dhe vlerësimin e aftësive praktike. Rregulloret përmbajnë shembuj specifikë për vlerësim. Udhëzimet për vlerësim nuk synojnë të jenë gjithëpërfshirëse, ato nuk pretendojnë t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve ose të shpjegojnë të gjitha rastet nga puna e përditshme. Synimi është që të përfshihen në një vend mënyra të pranueshme për vlerësimin në rrethana të ndryshuara, duke marrë parasysh aftësitë teknologjike dhe nivelin e vlerësuar të kompetencave të mësuesve. Rekomandimet janë të destinuara kryesisht për sistemin arsimor fillor dhe të mesëm, por me rregullime të vogla mund të përdoren nga universitetet dhe kolegjet, si dhe institucionet e arsimit për të rritur. Shihni më shumë në <https://skolazavivot.hr/upute-za-vrednovanje-i-ocjenjivanje-tijekom-nastave-na-daljnu/>

### Vlerësimi në arsimin e lartë

Vlerësimi në arsimin e lartë duhet të përfshijë përdorimin e metodave të vlerësimit në lidhje me rezultatet e dhëna të të nxëniet të lëndës. Meqenëse arsimit i lartë, veçanërisht mësimi universitar, do të thotë arritja e niveleve më të larta të rezultateve të të nxëniet, është mirë të përdoren detyra të projekteve dhe problemeve, punime kërkimore, zhvillim të programeve, portofola, konstruktive dhe vlerësime kritike, analiza dhe vlerësime. Një sistem i përshtatshëm është, për shembull, Moodle<sup>26</sup> që jep mundësi të gjera për përshtatje. Shumë mësues theksin e vendosin tek kolokviumet që zhvillohen në kushte të kontrolluara, por pa investime të mëdha në teknologjinë e re është e pamundur ta bësh atë në internet. Këto mjete bazohen në shfletuesit që veprojnë në mënyrë të sigurt ose në qasje të bazuara në identifikimin e fytyrës, zërit ose parametra të tjerë ergometrik. Sidoqoftë, disa nga këto kolektivime mund të zëvendësohen duke zgjidhur detyra të marra nga baza e të dhënave të detyrave, në mënyrë që secili student të marrë detyrat e tij. Sistemi i Menaxhimit me Mësimin (*Learning Management System - LMS*)<sup>27</sup> dhe Moodle përmbajnë mjete të shkëlqyera për këtë mënyrë të punës. Ato ofrojnë një larmi mundësish për parashtrimin e pyetjeve, duke lejuar mësuesit nga të gjitha fushat të përshtatin testet me nevojat e tyre.

Baza e një testi të mirë, relativisht i sigurt nga kopjimi, është bazë e të dhënave e madhe, me pyetje nga të cilat gjenerohen testet. Nëse pyetjet janë të organizuara sipas kategorive (sipas njësive mësimore / niveleve të vështirësisë), metoda e përzgjedhjes së rastësishme mund të shtohet drejt testeve me pyetje nga kategori të ndryshme, duke lejuar që secili student të marrë pyetje që mbulojnë materialin me peshë afërsisht të barabartë. Gjenerimi i pyetjeve bazuar në zgjedhjen e rastësishme dhe ndryshimi i renditjes së përgjigjeve për një periudhë kohe mund të ofrojë siguri dhe mbrojtje relativisht të mirë kundër përshkrimit të padëshiruar. Për më tepër, shumica e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kroacisë kanë qasje në një sistem të kontrollit të plagjiaturës. Prandaj, ai sistem duhet të përfshihet në vlerësim për të siguruar integritetin akademik.

Institucionet e arsimit të lartë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë studimeve nga fusha e artit dhe të vlerësojnë në cilat kushte dhe si është e mundur të bëhet një vlerësim gjatë mësimin në distancë. Është e nevojshme të rishpërndahen temat dhe përgjegjësitë e studentëve në mënyrë që të sigurohet mënyrë cilësore e të mësuarit. Qasje e ngjashme mund të zbatohet për shkollat e artit.

Sa i përket përmbajtjeve arsimore, përmbajtjet falas në internet, në formën e kurseve falas online - MOOCs (Massive Open Online Courses),<sup>28</sup> mund të shërbejë si material shtesë për studentët.

<sup>26</sup> <https://moodle.org/>

<sup>27</sup> [https://www.questionmark.com/?gclid=EAlaIqobChMlrK2tgsez6gIVSfIRCh0HdQznEAAYASAAEgKrBfD\\_BwE](https://www.questionmark.com/?gclid=EAlaIqobChMlrK2tgsez6gIVSfIRCh0HdQznEAAYASAAEgKrBfD_BwE)

<sup>28</sup> <https://www.mooc.org/>

### *Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i mësuesve*

Gjatë mësimit në distancë, këshillohet të realizohen pyetësor ndërmjet nxënësve dhe prindërve se sa të suksesshëm janë mësuesit në të gjithë procesin. Është e dobishme të ketë pyetje të hapura, në mënyrë që nxënësit dhe prindërit të bëjnë sugjerime specifike për përmirësimin e mësimit. Pavarësisht nga rezultati, është mirë të bisedohet me kolegët në mënyrë që të shkëmbehen informacione. Rezultatet gjithashtu mund të diskutohen me bashkëpunëtorët profesionistë për të gjetur zgjidhje dhe për të siguruar cilësinë e të mësuarit dhe të mësimit.

### *Aktiviteti i nxënësve*

Në mënyrë që nxënësit të fitojnë kompetencat e nevojshme për jetën në shekullin 21, ata duhet të jenë aktivë në procesin e të mësuarit, pikërisht në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë vetëdije se sa dinë dhe çfarë duhet të bëjnë akoma, që vërtet të arrijnë qëllimet e përcaktuara të procesit mësues. Një nxënës aktiv është ai që merr iniciativë, përpiket për pavarësi dhe inkurajon të tjerët të mësojnë. Mësimi në distancë mund të çojë në ndryshime të mëdha, si për shembull zakonisht nxënësit e qetë dhe të tërhequr, për shkak të aftësive dhe njohurive të tyre digjitale, mund të bëhen shumë aktivë dhe të pavarur, dhe kështu të stimulojnë të tjerët.

Aktiviteti dhe puna duhet të njihen dhe vlerësohen pozitivisht; duke filluar nga pjesëmarrja në diskutime në mjedisin virtual, përmes vlerësimit nga moshatarët e tyre dhe vetëvlerësimit, deri në hulumtime të pavarura dhe dhënien e sugjerimeve për mësim dhe kërkime të mëtejshme. Është veçanërisht e rëndësishme që nxënësit të hulumtojnë dhe kërkojnë në mënyrë të pavarur burime në internet, si dhe të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë e tyre. Pasi të kenë mbledhur informacione cilësore nga një larmi burimesh, ata duhet të jenë në gjendje të shkruajnë punim të pavarur në një fushë dhe strukturë të caktuar që do të përmbajë argumentet e nevojshme.

Në të gjitha lëndët, aktiviteti i nxënësit mund të vlerësohet përmes diskutimeve dhe detyrave të shtëpisë. Në secilën lëndë është e mundur të bëhet një detyrë më komplekse në formën e një posterit, prezantimi, projekti, pune kërkimore, prezantimi kritik ose detyrë e lidhur me problemin, dhe një punë e tillë mund të vlerësohet në mënyrë që tregon qartë elementet dhe kriteret për vlerësim.

## Për prindërit

### *Roli i prindërve / kujdestarëve*

Duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme, prindërit në këtë kohë më shumë se kurrë duhet të përfshihen në punën e shkollës, por edhe në sigurimin e një rrethi besimi për mësim, dhe kjo është veçanërisht e theksuar dhe e nevojshme për prindërit që kanë fëmijë nxënës në shkollën fillore. Duke qenë se të gjithë jemi në një situatë krejt të re dhe në një lloj të ri të mësimdhënies, është e rëndësishme që të gjithë - mësuesit, nxënësit dhe prindërit - të kenë mirëkuptim për njëri-tjetrin. Megjithëse kjo është e vështirë, duke pasur parasysh rrethanat, gjatë mësimin në distancë pritet nga prindërit më shumë sepse ata kanë kontakte të drejtpërdrejta të përditshme me nxënësit (fëmijët e tyre), kështu që përfshirja e tyre është e ndryshme sesa kur shumica e procesit arsimor zhvillohet në shkollë. Prindi duhet të sigurojë dhe përcaktojë rregullat e "shkollës në shtëpi" dhe të caktojë kohën për mësim, veçanërisht për klasat e shkollës fillore (duhet të jemi të vetëdijshëm se as fëmijët dhe as prindërit nuk e perceptojnë shtëpinë e tyre si shkollë).

Roli i prindit është të inkurajojë fëmijën të kryejë të gjitha detyrat në mënyrë të pavarur dhe ta inkurajojë atë që t'i drejtohet mësimdhënësve për çdo paqartësi. Është përgjegjësi e prindërve të ndihmojnë fëmijën, por jo të punojnë për të. Ndërsa është e kuptueshme që prindërit të përpiqen të marrin nota më të mira, ndihma e prindërve nuk duhet të jetë në shkrimin e detyrave të shtëpisë ose në ushtrimin e presionit ndaj nxënësve dhe mësuesve për të marrë nota më të mira. Normalisht që prindërit dëshirojnë të ndihmojnë, por ata nuk duhet ta bëjnë këtë në dëm të zhvillimit të përgjegjësisë dhe pavarësisë tek fëmijët. Ndihma joadekuate do të zvogëlojë shanset e fëmijëve për tu përballuar në mënyrë të pavarur në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe në zgjidhjen e përditshme të problemeve. Prindërit janë ata që duhet të rrisin fëmijët e tyre që të mos mashtrojnë, të mos kopjojnë dhe të vlerësojnë punën dhe mundin - si të tyre ashtu edhe të të tjerëve. Ata duhet t'i inkurajojnë fëmijët të mësojnë, hulumtojnë dhe organizojnë mirë kohën e tyre, por gjithashtu t'i ndihmojnë ata të mësojnë se si të mësojnë.



**MBRETËRIA E BRITANISË SË MADHE DHE  
IRLANDËS VERIORE**



Në Britaninë e Madhe, mësimi në distancë zhvillohet vetëm për grupe të caktuara moshe: në institucionet ekzistuese edukuese - arsimore kthehen fëmijët e moshës parashkollore, përkatësisht ata të moshës deri më gjashtë vjeç ndërsa sistemi arsimor mbetet i mbyllur për të gjitha grup moshat e tjera, me përjashtim të fëmijëve të a.q. „punëtorët kyç (më të nevojshëm)” dhe për fëmijët nga kategoritë e rrezikuara të cilët nuk mund të ndjekin mësimin nga shtëpia, vetëm. Më të vegjëlve u jepet përparësi sepse janë në fillim të procesit arsimor dhe ende nuk kanë përvetësuar bazat si numërimin, leximin dhe shkrimin, por edhe mësimin e socializimit dhe shoqërimit me shokët e tyre të shkollës. Prioriteti për kthimin në shkollë përfshin gjithashtu ato grupe nxënësish që janë në një fazë kalimtare, për shembull ata që po kalojnë nga arsimi fillor në atë të mesëm, sepse është e nevojshme të përgatiten mirë për sfidat e nivelit tjetër arsimor.

Është siguruar një platformë arsimore elektronike për grupet e tjera të nxënësve (më tutje në tekst - *Platformë*) që përmban udhëzime praktike për realizimin e mësimin në distancë për mësuesit, drejtorët e shkollave, prindërit, kujdestarët dhe nxënësit. Të dhënat e Platformës azhurnohen rregullisht për të përfshirë burime të reja shtesë, informacione dhe zhvillimet më të fundit.<sup>29</sup> Për të ndihmuar prindërit, roli arsimor i të cilëve në rrethanat e reja po merr rëndësi, procesi arsimor në nivel shtetëror promovon një seri prej 180 internet - leksione për nxënësit në arsimin fillor.

Megjithatë, duhet të theksohet se nivelet e sfidës dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato ndryshojnë në shkollat individuale në Mbretërinë e Bashkuar, kështu që është e qartë se shkollat kanë nevojë për fleksibilitet për të planifikuar dhe ofruar mësim në distancë të përshtatura me rrethanat e tyre specifike. Për shembull, arsimi në distancë për fëmijët më të vegjël zakonisht kërkon më shumë përfshirje të prindërve të cilët, nga ana tjetër, përballen me shumë presione të ndryshme në këtë kohë. Shembujt më të suksesshëm të mësimin në distancë vijnë nga shkollat që tashmë kanë një infrastrukturë të caktuar dhe teknologji të përshtatshme, përkatësisht duhet të merret parasysh se shumë shkolla dhe familje nuk kanë të njëjtin nivel / mundësi për qasje në internet, kështu që Platforma ofron shembuj të praktikës efektive ose, nga ana tjetër, sugjeron vetëm se si të sigurohet arsimim për kategori të ndryshme të nxënësve.

<sup>29</sup> <https://www.gov.uk/government/publications/coronavirus-covid-19-online-education-resources>

Në të gjithë këtë proces, mirëqenia e nxënësve është në vend të parë. Prandaj, sigurohet mbështetje për prindërit, mbështetje për nxënësit (e përshtatshme për moshën të ndryshme), ndihmë në organizimin e kohës dhe një gamë të gjerë të materialeve arsimore që mund të përdoren ose si burime mësimore ose si shembuj të përbashkët të mësimin në distancë. Përveç kësaj, përmes një portali qeveritar të krijuar në mënyrë përkatëse, është ofruar mbështetje teknologjike dhe trajnim për përdorimin e tij, dhe BBC - shërbimi kombëtar i televizionit publik - është i përfshirë në të gjithë procesin. Që nga fillimi i mësimin në distancë, është konstatuar problemi kryesor i dallimeve sociale. Është vërtetuar se ekziston e aq. "Varfëria digjitale", pra në disa shkolla nxënësit nuk kanë as laptopë as kompjuter.

Në vazhdim, veçojmë elementë që i konsiderojmë më të dobishëm.

### Për prindërit

#### *Mbështetje e procesit të mësimin gjatë virusit Corona*

Ndërsa qëndrojnë në shtëpi për shkak të pandemisë së virusit, prindërit dhe kujdestarët sigurisht që janë të shqetësuar për zhvillimin e fëmijëve të tyre edhe për pasojat e ndërprerjes së procesit arsimor ose ndërprerjes së qëndrimit në kopsht. Askush nuk pret që prindërit të jenë mësues ose të kryejnë aktivitete që zakonisht përfshijnë shkollën dhe kopshtin. Sidoqoftë, prindërit dhe kujdestarët duhet të bëjnë çmos për të ndihmuar fëmijët dhe për të mbështetur mësimin, dhe në të njëjtën kohë të merren me përgjegjësi dhe sfida të tjera. Ekzistojnë udhëzime me këshilla përkatëse për vazhdimin e procesit arsimor nga shtëpia, të përshtatura për grupe të caktuara moshë, veçanërisht për prindërit e fëmijëve të moshës nga 2 deri në 4 vjeç, për prindërit e fëmijëve të shkollës fillore, për prindërit e fëmijëve të shkollës së mesme dhe për prindërit e fëmijët me nevojë të veçanta arsimore, ose fëmijët me aftësi të kufizuara (merret parasysh që secila grupmoshë ka specifikat e veta). Udhëzimet, kryesisht përbëhen nga shembuj se si të organizohet koha në mënyrë më efektive, ndërsa për fëmijët më të vegjël, mbi të gjitha, se si të zotërojnë aftësitë themelore të jetës, por megjithatë të ruhet loja e përditshme. Për shembull, fëmijët më të vegjël mund të ndihmohen të mësojnë përmes gjërave të përditshme dhe gjërave që prindërit bëjnë me ta përmes bisedave të përditshme, lojërave me numra ose letra, bashkë-leximi, përfshirjes në punët e përditshme të shtëpisë. Sugjerohen ide novatore dhe faqe interesante në internet (si p.sh. *Mendje të Vogla të Uritura - Hungry Little Minds*)<sup>30</sup> Në çdo rast, nuk rekomandohet të caktohet në mënyrë rigorozë koha për planifikimin e aktiviteteve komplekse të dedikuara vetëm për të mësuar, por rekomandohet që aktivitetet të përfshihen në jetën e përditshme dhe të kryhen përmes lojës. Prindërit i njohin më mirë fëmijët e tyre, kështu që aktivitetet e planifikuara afatgjata duhet të

<sup>30</sup> <https://hungrylittleminds.campaign.gov.uk/>

shmangen, këtu duhet të praktikohet një përbërje e përzier e aktiviteteve më të shkurtra, të cilave fëmijët, natyrshëm, u përgjigjen më mirë. Kështu, shmangjet fëmijët të mërziten ose të zhgënjehen, përkatësisht është e nevojshme që fëmijët të qëndrojnë aktivë dhe të interesuar të mësojnë përmes gjërave me të cilat kënaqen.

Për më tepër, janë siguruar burime arsimore elektronike në internet që mbulojnë një larmi temash për grup moshë të ndryshme. Vëmendje i kushtohet sigurisë së përmbajtjeve në internet dhe mënyrës së qasjes dhe bisedës me fëmijët në lidhje me të. Në të gjitha pajisjet e përdorura nga fëmijët, është propozuar që të vendoset kontrolli dhe mbikëqyrja prindërore mbi përdorimin e ueb faqeve dhe aplikacioneve. Në çdo rast, është e nevojshme të zvogëlohet koha e kaluar para ekranit sepse pajisjet digjitale nuk janë mënyra e vetme për të mësuar. Është e nevojshme të përdoren libra dhe materiale të tjera të shtypura të siguruar nga shkolla ose ato që fëmijët kanë në shtëpi.

Prindërit e fëmijëve në grupin kalimtar (ata që kalojnë nga shkolla fillore në shkollën e mesme) këshillohen praktikisht se si tu ndihmojnë ta bëjnë këtë ndryshim më të lehtë - si të punojnë me fëmijën, si të japin informacion kthyes për punën e tyre ose, nga ana tjetër, u tregohen mënyra për të kontrolluar progresin e të nxëniet. Përveç të gjitha detyrave të shtëpisë që marrin fëmijët nga shkolla, mund të përdoren programe arsimore të disponueshme në BBC, shërbimi kombëtar i televizionit publik<sup>31</sup> ose përmes OAK-së, Akademisë Kombëtare.<sup>32</sup> Që nga paraqitja e Covid-19, është siguruar linjë telefonike falas me mbështetje dhe këshilla për prindërit rreth mësimin nga shtëpia. Nëse disa prindër nuk janë në gjendje t'i sigurojnë fëmijës përdorimin e një pajisje digjitale për obligimet e shkollës, atëherë ata mund të kontaktojnë shkollën që do të sigurojë pajisje të tillë ose të lejojë nxënësi të punojë në format tjetër, megjithatë mos humbë nga mësimi.

### *Ruajtja e shëndetit mendor dhe mirëqenies*

Ndryshimi i rutinës dhe qëndrimi në shtëpi mund të jetë e vështirë për disa fëmijë. Është veçanërisht e rëndësishme të ruhet mirëqenia e fëmijëve. Ekzistojnë udhëzime të përgatitura me mbështetje të institucioneve të shëndetit publik që tregojnë se si prindërit duhet të kujdesen për shëndetin e tyre mendor, por edhe për shëndetin e fëmijëve të tyre. Duhet të ruhet rutinë ditore në të cilën fëmijët do të ndihen më rehat (për shembull, të zgjohen në të njëjtën kohë, të flenë në të njëjtën kohë, të hanë në të njëjtën kohë, etj.). Për më tepër, ka sugjerime për të praktikuar aktivitete dhe lojëra në natyrë që nuk e rrezikojnë shëndetin e fëmijëve. Rëndësia e shoqërizimit theksohet veçanërisht, sepse ashtu si të rriturit, është e rëndësishme që fëmijët të arrijnë dhe mbajnë komunikimin me bashkëmoshatarët. Prandaj, propozohet të vendoset video konferencë me fëmijë të tjerë ose bisedë me një rreth më të gjerë të të afërmeve, përmes së cilës mund të ndajnë përvojat dhe aktivitetet.

<sup>31</sup> <https://www.bbc.co.uk/bitesize>

<sup>32</sup> <https://www.thenational.academy/>

Fëmijët nuk duhet të ngarkohen me lajme dhe informacione të tjera në lidhje me pandeminë, por natyrisht që duhet t'u jepet kohë të flasin hapur për ndjenjat e tyre. Biseda me fëmijët më të vegjël për situatën e re, sigurisht paraqet sfida të madhe sepse, nga njëra anë, prindërit nuk do të dëshironin t'i shqetësonin më tej, dhe nga ana tjetër, ata duhet të gjejnë një mënyrë për të mos e injoruar kuriozitetin e tyre të vazhdueshëm. Gjëja më e rëndësishme është që fëmijët të ndjehen të sigurt dhe të bindur se kjo gjendje është kalimtare.

### *Për shkollat*

Përgjegjësia kryesore e shkollës është të sigurojë kujdes dhe mbështetje për nxënësit në zhvillimin e tyre social, personal dhe akademik. Shkollat duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me nxënësit, dhe veçanërisht me kategoritë e rrezikuara të nxënësve. Provimet e drejtpërdrejta duhet të shtyhen dhe duhet të vendoset një sistem i ri i notave për të pasqyruar aktivitetin e nxënësve. Shkolla duhet të mbajë llogari për notat e grupit, kolektivit, notat mesatare në nivelin e një klase të caktuar, bazuar në rezultatet / notat e fituara pas kryerjes së provimeve individuale. Shkollat pastaj i rangojnë nxënësit në kuadër të secilës lëndë individualisht dhe në secilën klasë. Informacioni u dërgohet këshillave të provimit për të standardizuar notat nëpër shkolla dhe për të siguruar që asnjë shkollë të mos jetë shumë e rreptë ose shumë e butë, përkatësisht të sigurohet vlerësimi i drejtë. Është siguruar edhe mekanizëm për ankesa nëse konsiderohet se ekziston padrejtësi në këtë proces.

### *Burimet*

Për realizimin e arsimit në shtëpi, derisa të rikthehet procesi i zakonshëm, normal arsimor, është bërë një listë e burimeve falas për trajnim në internet, veçanërisht për matematikë, për online shkencë, anglisht, si dhe programe të veçanta arsimore për personat me aftësi të kufizuara dhe persona me invaliditet. Këto burime janë vetëm sugjerime dhe nuk shërbejnë për të zëvendësuar planin mësimor të hartuar të shkollës, por shërbejnë për të ndihmuar shkollat të pasurojnë burimet e tyre ekzistuese. Burimet shitesë në dispozicion vlerësohen nga ekspertët dhe ofrojnë në mënyrë të garantuar cilësi të lartë arsimore. Ato janë përshtatura me nevojat e nxënësve, dhe janë teknikisht të adaptueshme gjithashtu të përdoren edhe nga prindërit. Lista e burimeve shitesë nuk është përfundimtare, pra azhurnohet vazhdimisht. Mësuesit dhe prindërit / kujdestarët duhet të sigurohen që aktivitetet e përfshira në burimet e sugjeruara janë të përshtatshme dhe të sigurta për moshën e nxënësit dhe që ato të mund të kryhen në mënyrë të sigurt në mjedisin e shtëpisë.

## *Financimi dhe ndihma teknike*

Në situatën shoqërore të re, të krijuar, Britania e Madhe ka siguruar mbështetje financiare për arsimin në distancë, por edhe për kujdesin për fëmijët në një kuptim më të gjerë, duke përfshirë mbështetjen e duhur teknike për të gjithë procesin arsimor. Është siguruar financim i jashtëzakonshëm i shpenzimeve të shkollave, mundësi për përmirësimin e aftësive digjitale me kurse falas në internet, si dhe ndihmë teknike themelore - qasje në internet, përdorim i pajisjeve digjitale, mbështetje në zbatimin e mësimin në distancë. Ndihma vjen gjithashtu nga autoritetet lokale përmes pajisjeve digjitale falas dhe aksesit falas në internet, përgatitjes së formave speciale përmes të cilave të aplikojnë për ndihmë, shpërndarjen e pajisjeve (*laptopë dhe tabletë për mësuesit, fëmijët dhe të rinjtë*) dhe të ngjashme. Ekziston edhe sektor i veçantë i arsimit që siguron mbështetje për nxënësi nga familjet në rrezik social që nuk kanë qasje as në pajisjet digjitale dhe as në internet, gjatë çka autoritetet lokale janë përgjegjëse për porositjen dhe shpërndarjen e laptopëve dhe tabletëve. Për këtë lloj të ndihmës shtetërore mund të aplikojnë vetëm nga autoritetet lokale, institucionet dhe organizatat e tjera përkatëse që mbikëqyrin shkollat, si dhe institucionet në fushën e mbrojtjes sociale, dhe jo shkollat, prindërit dhe nxënësit. Është krijuar sistem funksional i organizimit dhe kontrollit, dhe laptopët dhe tabletët dorëzohen brenda 5 ditë pune nga dita e porosisë. Në këtë proces, kategorizimi shtesë bëhet sipas prioritetit, përkatësisht personat nga kategoritë më të rrezikuara sociale kanë përparësi. Laptopët dhe tabletët dorëzohen drejtpërdrejt te shkollat ose autoritetet lokale të shënuara në aplikacion, dhe ata më tej bëjnë shpërndarjen dhe distribuimin.

## *Për mësimdhënësit*

Janë siguruar Informacione - strategji dhe praktika - të nevojshme për mësuesit në zbatimin e procesit arsimor në të ashtuquajturin "Mjedisi i shtëpisë". Strategjitë dhe praktikat janë zhvilluar nga Ministria e Arsimit në partneritet me sektorin e arsimit.

## *Burimet e mësimdhënies*

Platforma e lartpërmendur përmban burime që duhet të ndihmojnë mësuesit, përkatësisht një listë të përgjithshme të burimeve për arsimin në internet, duke mbuluar një larmi temash të kategorizuara sipas grupeve të moshës. Burimet e propozuara përfshijnë:

*Bitesize Daily*<sup>33</sup> - program i zhvilluar nga BBC për nxënësit e klasave 1 deri në 10, program që ofron orë të reja arsimore çdo ditë. Është krijuar në bashkëpunim me mësuesit dhe ekspertët arsimorë, dhe videot dhe aktivitetet e tij ndërvepruese përfshijnë shtjellimin e temave elementare dhe të veçanta nga programet shkollore. Përmbajtja është në dispozicion falas - në TV, në internet dhe përmes iPlayer të BBC-së.

<sup>33</sup> <https://www.bbc.co.uk/bitesize/dailylessons>

*OAK - Akademia Kombëtare*<sup>34</sup> - Mësuesit gjithashtu kanë burimet në dispozicion nga OAK, akademia kombëtare e krijuar nga mësuesit e shkollave anembanë Anglisë si përgjigje ndaj mbylljes së shkollave. Ky burim falas për mësuesit siguron ekuivalentin e tre orëve në ditë për nxënësit e shkollës fillore dhe katër orë në ditë për nxënësit e shkollës së mesme, për një larmi të përmbajtjesh dhe tema mësimore. Mësimet janë krijuar përmes ushtrimeve dhe kombinimeve të videove, kuize dhe fletëve të punës. Shkollat, nëse duan ta përdorin atë si pjesë të planit mësimor për arsim në distancë, mund të shkarkojnë paketën e plotë të të ashtuquajturës "OAK Shkollë",<sup>35</sup> që ofron udhëzime dhe video për shpërndarje. Paketa është në dispozicion për shkollat fillore, të mesme dhe të specializuara dhe përfshin plan-program të plotë deri në fund të semestrit pranveror.

### *Planifikimi i mësimdhënies*

Janë zhvilluar udhëzime për planifikimin e strategjive të mëimit në distancë përmes këshillave praktike. Kjo paraqet mundësi që shkollat të mësojnë nga njëra-tjetra, si dhe të zhvillojnë qasjet e tyre për ofrimin e arsimit në distancë. Prandaj, shembuj të shumtë të praktikave mësimore janë tashmë në dispozicion, dhe ato azhurnohen vazhdimisht për të gjitha nivelet e arsimit dhe për të gjitha grupet arsimore. Një sfidë e veçantë është harmonizimi i procesit mësimor në lidhje me nxënësit që shkojnë në shkollë vazhdimisht nga fillimi i pandemisë, me ata që sapo kanë filluar të kthehen në shkollë dhe me ata që janë akoma në shtëpi. Kjo është arsyeja pse një plan-program koherent është i nevojshëm për të dhënë mësim për nxënësit në shtëpi dhe ata në shkollë, duke ruajtur distancën sociale dhe sigurinë për të punësuarit dhe nxënësit. Sigurisht, është e nevojshme të mbështesim të punësuarit në planifikimin e kthimit në faza, të procesit mësimor, si dhe në identifikimin e boshllëqeve në njohuritë e nxënësve. Në këtë proces, mësuesve u ofrohet ndihmë teknike, si sigurimi i mësimave virtuale dhe transmetim i drejtpërdrejtë, si dhe sugjerime për komunikim me prindërit, kujdestarët dhe nxënësit për të siguruar procesin e përgjithshëm arsimor.

### *Siguria e internetit*

Mësimi në distancë është një përvojë e re si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit, prandaj është e rëndësishme që shkollat të kenë strategji për të siguruar, sigurinë në internet (*mbrojtja e të dhënave personale, mbrojtja nga përmbajtje të dëmshme, mbrojtja nga radikalizimi përmes internetit, mbrojtja nga përmbajtje të dëmshme ose shqetësuese, si dhe mbrojtje nga ngacmimet dhe abuzimet përmes internetit, etj.*), dhe në atë drejtim

<sup>34</sup> <https://www.thenational.academy/>

<sup>35</sup> <https://www.thenational.academy/schools-pack>

janë dhënë shumë këshilla dhe udhëzime që sugjerojnë koordinimin e nevojshëm me prindërit dhe kujdestarët.<sup>36</sup> Është e rëndësishme që çdo shqetësim të komunikohet përmes kanaleve të qarta të raportimit në mënyrë që të merren hapat e duhur. Në këtë drejtim, sigurohet linja telefonike falas për kontakt me profesionistë.

### *Komunikim i rregullt me prindërit, kujdestarët dhe nxënësit*

Si pjesë e mësimit në distancë, është veçanërisht e rëndësishme për shkollat, mësuesit dhe nxënësit të mbajnë komunikim të vazhdueshëm. Prandaj, leksionet në transmetim të drejtpërdrejtë dhe video-konferencat janë të rëndësishme. Mësimi nga shtëpia është i ndryshëm nga mësimdhënia në klasë. Mësuesit duhet të përpiqen të gjejnë kohë për të biseduar me nxënësit, prindër ose kujdestarët.<sup>37</sup> Prindërit, kujdestarët dhe nxënësit duhet të ndihmohen në përgatitjen e një plani ose strukture javore që përfshin kohë për edukim, lojë dhe relaksim, dhe ky plan do të zvogëlojë stresin dhe ankthin te familjet që janë në situatë të pa sigurt.

<sup>36</sup> Thinkuknow ofron këshilla nga Agjencia Kombëtare e Krimin (NCA) mbi sigurinë kibernetike. Informacioni i ofruar siguron mbështetje dhe udhëzime për prindërit nga ekspertë dhe organizata kryesore <https://www.thinkuknow.co.uk/>; Childnet ofron mjet për të mbështetur prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve të të gjitha moshave të fillojnë diskutime mbi jetën e tyre në internet, të vendosin kufij rreth sjelljes në internet dhe përdorimit të teknologjisë dhe të kuptojnë se ku mund të gjejnë më shumë ndihmë dhe mbështetje. Internet temat, sigurojnë lista për siguri në internet të specifikuar për moshën, udhëzime se si të vendosen kontrollet prindërore në shumë pajisje dhe shumë këshilla praktike për t'i ndihmuar fëmijët të përfitojnë sa më shumë nga bota e tyre digjitale <https://www.childnet.com/>; një mjet i tillë është London Grid for Learning, <https://www.lgfl.net/>

<sup>37</sup> Autoritetet lokale duhet të koordinohen me shkollat dhe t'u sigurojnë mësuesve vend të sigurt për të punuar nëse nuk janë në gjendje të japin mësim nga shtëpia;



**REPUBLIKA E IRLANDËS**



Në Republikën e Irlandës, theksohet veçanërisht nevoja për koordinim efektiv midis aktorëve kryesorë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e procesit të mësimin në distancë, përkatësisht rolet janë shpërndarë në mënyrë të barabartë midis shkollave, mësuesve, nxënësve dhe prindërve.

Në vazhdim, veçojmë elementë që i konsiderojmë më të dobishëm.

### *Mbështetja e mësuesve*

Platforma arsimore e Republikës së Irlandës karakterizohet nga ofrimi i mundësive për ndihmë profesionale për mësuesit gjatë sigurimit të shërbimeve arsimore. Ekipet e *Shërbimit të Zhvillimit Profesional për Mësuesit (Professional Development Service for Teachers – PDST)*<sup>38</sup> kanë zhvilluar një mori burimesh të mësimin në distancë për të mbështetur shkollat gjatë gjithë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë. Burimet janë në dispozicion në fushat e mëposhtme: teknologjitë digjitale; shëndet dhe mirëqenie; udhëheqja e shkollës; shkrim-leximi; matematikë dhe gjeografi. Ministria e Arsimit i angazhon udhëheqësit e shkollave dhe drejtorët e shkollave që të vazhdojnë menjëherë procesin arsimor dhe thekson rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm të mësuesve në jetën e të rinjve, pra mbështetjen e vazhdueshme të pritshme, e cila është jetike në krizën aktuale. Përgjatë këtij plani të sapo krijuar, Ministria vetëm drejton procesin duke u dhënë arsimtarëve akses në materiale edukative, si dhe burime të TI që azhurnohen rregullisht përmes Scoilnet.<sup>39</sup> Mësuesit inkurajohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me prindërit dhe kujdestarët për mbështetjen e plotë të nxënësve. Në këtë fazë, është veçanërisht e rëndësishme të ruhet vazhdimësia e arsimit për nxënësit e të gjitha niveleve të sektorit arsimor. Për më tepër, përmes një ekipi të përkatës, ekspertësh, ofrohen shërbime për zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe përmbajtje në internet për të mbështetur përdorimin e teknologjisë digjitale për shkollat dhe mësuesit e përfshirë në mësimin në distancë. Për këtë qëllim, është ngritur një ueb faqe e veçantë me përmbajtje edukative, e zhvilluar nga një ekip për teknologji digjitale, dhe platformat dhe mjetet elektronike

<sup>38</sup> <https://www.pdst.ie/>

<sup>39</sup> <https://www.scoilnet.ie/>

janë përpunuar dhe shpjeguar në detaje.<sup>40</sup> Duke përdorur online mjetet e kësaj faqe, mësuesit mund të përshtatin me lehtësi programin e tyre arsimor duke përdorur burimet e disponueshme të mësimdhënies dhe duke bërë ushtrime / detyra shtëpie për nxënësit. Mjetet janë të unifikuara dhe në varësi të kapacitetit teknik të shkollave, mësimdhënësve u lejohet të përdorin strategji të ndryshme për krijimin e online mësimit. Për shembull, njohuritë e nxënësve mund të testohen në mënyrë efektive duke përdorur mjete të tilla si: edpuzzle; flipgrid; kahoot; quizlet dhe wizer.me<sup>41</sup>, dhe nga mësuesit kërkohet që t'u japin nxënësve informatë kthyesë të zgjeruar se ku duhet të korrigjohen gjatë mësimit.

I gjithë ky proces mbështetet nga udhëzime digjitale dhe tutoriale. Secila shkollë, në përputhje me nevojat dhe kapacitetet e saj, mund të zgjedhë se cilën platformë mësimore do të përdorë, por në të njëjtën kohë, biblioteka të shumta elektronike janë në dispozicion falas.

### *Mbështetje për prindërit*

Udhëzimet se si të zhvillohet mësimi në kohë pandemie jepen nga *Shërbimi Kombëtar Psikologjik për Arsim (National Educational Psychological Service-NEPS)*,<sup>42</sup> azhurnohet vazhdimisht dhe vlen njësoj për prindërit, të rinjtë dhe mësuesit. Në dispozicion në [www.education.ie/covid19](http://www.education.ie/covid19), ndërsa Departamenti për Arsim dhe Shkathtësi ofron shërbime dhe mbështetje, përkatësisht është vazhdimisht i disponueshëm për të siguruar vazhdimin e arsimit. Faqja përmban katalog të artikujve për mbështetjen e prindërve që botohen edhe në javoren *The Irish Times*, si pjesë e serisë së teksteve - "Të mësuarit nga shtëpia".<sup>43</sup> Çdo tekst eksploron aktivitete praktike dhe efektive për të mbështetur dhe forcuar procesin e të mësuarit nga shtëpia. Janë prezantuar shembuj, si: tregimi digjital i përrallave, mënyra për të inkurajuar krijimtarinë gjatë mësimit nga shtëpia, si t'i mbajmë fëmijët të lumtur dhe të shëndetshëm ndërsa shkollat janë të mbyllura, si të sigurohet mirëqenia e fëmijëve, udhëzues praktik për të folur me fëmijët për ndjenjat dhe shqetësimet e tyre. Përveç mbështetjes psikologjike, sigurohen materiale dhe burime për punë praktike mësimore, për shembull: për shkencë dhe gjeografi, për hulumtim dhe vëzhgimin e mjedisit shtëpiak, krijimin e një kapsule kohore digjitale familjare, aventura krijuese gjatë një turneu virtual dhe të ngjashme. Uebinarët janë gjithashtu të disponueshëm në fusha të ndryshme me panele shtesë të ekspertëve, si për shembull uebinar për mësim nga shtëpia, mënyra

<sup>40</sup> <https://www.pdst.ie/distancelearning>

<sup>41</sup> <https://edpuzzle.com/>; <https://info.flipgrid.com/>; <https://kahoot.com/>; <https://quizlet.com/live>; <https://www.wizer.me/>

<sup>42</sup> <https://www.education.ie/en/Schools-Colleges/Services/National-Educational-Psychological-Service-NEPS-/NEPS-Home-Page.html>

<sup>43</sup> <https://www.irishtimes.com/news/education/home-tuition-our-guide-to-the-best-teaching-and-learning-resources-online-1.4206766>

krijuese për të qëndruar të lidhur dhe mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimin në distancë. Uebinaret janë të sistemuar nga plotësisht arsimore për të gjitha nivelet e arsimit, në ato të specializuara që ofrojnë mbështetje për mësuesit ose drejtorët e shkollave.

### *Burimet digjitale*

Ueb faqja e përmendur përmban një mori platformash për mësim në distancë. Në vazhdim janë dhënë disa shembuj.

**Epic!** është internet bibliotekë që ofron mbi 35000 burime, duke përfshirë edhe libra nga audioedicioni "Read to Me ", më pas, mundësi për t'u lidhur me një lexues të zgjedhur dhe për të vendosur modelet e leximit. Biblioteka ofron tekste interesante nga National Geographic Kids ose Libri i Rekordeve Guinness, është gjithashtu i përshtatshëm për fëmijët e moshës 4-12 vjeç.<sup>44</sup>

**Britannica**, që nga viti 1768 është botues i enciklopedive shumëvëllimëshe. Ato janë digjitalizuar plotësisht për të përmbushur nevojat e shekullit 21, por përmbajtja e tyre azhurnohet çdo ditë me video, fotografi dhe mjete të tjera mësimore. Enciklopeditë janë në dispozicion në formate digjitale, të dizajnuara si produkte elektronike për nxënësit e të gjitha moshave. **Britannica** ofron përmbajtje falas për shkencat natyrore dhe shoqërore për të gjitha nivelet e arsimit.<sup>45</sup>

**DK Findout**<sup>46</sup> është burim rrjeti i përbërë nga enciklopedi shkollore dhe mund të keni qasje tek e njëjta nga shtëpia, duke inkurajuar nxënësit të mësojnë më shumë rreth një teme të caktuar. Përmbajtja mund të filtrohet në përputhje me fushën e mësimin dhe rezultatet e artikujve janë interaktive (për disa fusha ka kuize për të kontrolluar njohuritë). Mësuesi mund t'u japë nxënësve tema edhe nga ky burim, përveç që të bëjë projekte ose, përmes ese-ut, mund t'u referohen artikujve të caktuar enciklopedikë. Kjo faqe e internetit gjithashtu përmban libra shkollor falas, plane mësimore dhe fletë pune për mësuesit (në dispozicion në: <https://www.dkfindout.com/uk/teachers/>) Shembuj të hartuar me shkathtësi të jashtëzakonshme për përmbajtje që zgjojnë lehtësisht kuriozitetin e nxënësve janë ato rreth parahistorisë, trupit të njeriut, planetëve të sistemit diellor - shumë argëtuese, interaktive dhe të shoqëruara me video të pasura me fakte të dobishme dhe interesante. Faqja gjithashtu ka një seksion të veçantë për prindërit përmes të cilit fëmijës i sigurohet mjedis i sigurt për kërkimin, mësimin dhe hulumtimin e pavarur të informacionit. Është krijuar në mënyrë konstruktive, si një ndihmë e përsosur për t'i bërë detyrat e shtëpisë,




<sup>44</sup> <https://www.getepic.com/>

<sup>45</sup> <https://kids.britannica.com/> përveç kësaj në faqen kryesore të Scoilnet ([www.scoilnet.ie](http://www.scoilnet.ie)) ose mund të gjendet këtu <https://packs.eb.co.uk/hss>







<sup>46</sup> <https://www.dkfindout.com/uk/>

e qartë, koncize, e sigurt dhe plotësisht e animuar. Mbulon të gjitha lëndët nga programi mësimor, të paraqitura në mënyrë moderne shumë tërheqëse për nxënësin. Faqja gjithashtu përmban artikuj ekspertësh që u shpjegojnë prindërve vendosjen e programeve mësimore, në mënyrë që ata të mund të përfshihen vetë në procesin arsimor.<sup>47</sup>

**Tabela 2. Propozimi për video platformat**

	<p><i>YouTube</i> video platforma më e popullarizuar globalisht që ka video të shumta edukative dhe informuese, të lehta për tu kërkuar dhe shpërndarë përmes platformave në internet, postës elektronike dhe ngjashëm.</p>
<p><b>WatchKnowLearn</b> Free educational videos. Organized.</p>	<p><i>WatchKnowLearn</i> indeksoi afërsisht 50,000 video edukative, duke i vendosur ato në një vend me mbi 5,000 kategori.</p>
<p><b>TEDEd</b></p>	<p><i>TED-Ed</i> dhe <i>TED's youth</i> është iniciativë arsimore, në segment të caktuar që synon veçanërisht të rinjtë. Misioni i <i>TED-Ed</i> është të inkurajojë dhe popullarizojë idetë e mësuesve dhe nxënësve në të gjithë botën.</p>
	<p><i>TeacherTube</i> është komunitet falas për ndarjen e videove udhëzuese dhe përmbajtjeve - i krijuar për mësuesit dhe nxënësit.</p>
 <p><b>KHANACADEMY</b></p>	<p><i>KHAN Academy</i> ofron udhëzime, video mësimore dhe tryezë të personalizuar të të mësuarit që u mundëson nxënësve të mësojnë me ritmin e tyre - brenda dhe jashtë klasës.</p>

<sup>47</sup> <https://www.dkfindout.com/uk/parents/>

	<p><i>Vimeo</i> është një video platformë pa reklama, që bart mijëra video të prodhuara në mënyrë profesionale.</p>
	<p><i>SchoolTube</i> është një faqe në internet që u jep mësuesve dhe nxënësve qasje në videot mësimore dhe përmbajtje mësimore.</p>
<p><b>GJUHA DHE LITERATURA</b></p>	
	<p><i>Storyline Online</i> është thesar historik të lexuara nga persona të famshëm. Çdo libër përfshin material shtesë me qëllim që të rritë aftësitë e të kuptuarit, verbal dhe të shkruar.</p>
	<p><i>The Literacy Shed</i> është faqe e animuar për inkurajimin e lexim-shkrimit vizual dhe përmes saj lexim-shkrimi letrar për nxënësit e shkollës fillore.</p>
	<p><i>Storyberries</i> - tregime të vizualizuara/të animuara për mësuesit e shkollës fillore.</p>
	<p><i>KidLit</i> është koleksion videosh, i krijuar në bashkëpunim me autorë të librave për fëmijë dhe ilustrues; videot përmbajnë libra për leximin e aktrimit, intervista me autorë për fëmijë dhe ushtrime tematike artistike përveç lexim-shkrimit letrar.</p>

## THESAR KOMBËTAR



**Kanali YouTube** - i mbushur me tregime, sport dhe zanate të veçuara në shoqërinë dhe kulturën e Republikës së Irlandës.



**Kanali YouTube** - video nga librat shkollorë në gjuhën irlandeze, të lexuara nga autorë irlandezë, botues dhe aktorë irlandezë.

## EDUKIMI FIZIK



**Scoilnet / PSDT** - videot përdoren për të mbështetur të gjitha nivelet e programit bazë të edukimit fizik. Faqja mbështetet gjithashtu nga Fondacioni Irlandez i shëndetit të zemrës.



**Scoilnet** - video mbi kulturën fizike.









# GoNoodle

**GoNoodle** - video për zhvillimin e kulturës fizike shkollore, në lidhje me burimin - "është mirë të lëvizni shpesh".

## ARTET VIZUALE



**I am an Artist** - video për të mbështetur të gjitha nivelet e programit mësimor të arteve vizuale në shkollën fillore.

 <p><b>nationalgalleryie</b> 900 subscribers</p>	<p><b>Nationalgalleryie</b> - video nga Galeria Kombëtare e Republikës së Irlandës duke eksploruar dhe shpjeguar disa nga veprat e famshme kombëtare të artit.</p>
<p><i>SHKENCA</i></p>	
	<p><b>CRASH COURSE KIDS</b> - tema shkencore me video për nxënësit e shkollës fillore; Faqja përfshin një gamë të gjerë temash, përfshin edhe vendbanime, inxhinieri, hapësirën, etj.</p>
	<p><b>National Geographic Kids</b> ka ueb-faqe aktive që ka me bollëk burime interaktive, të ndara në mënyrë tematike.</p>
<p>Ueb-sajtet më poshtë u lejojnë mësuesve të heqin reklammat nga videot, si dhe t'i presin ato në seksione përpara se t'ua dërgojnë nxënësve.</p>	
	<p><a href="http://www.viewpure.com/">http://www.viewpure.com/</a></p>
	<p><a href="https://safeshare.tv/">https://safeshare.tv/</a></p>
	<p><a href="https://www.tubechop.com/">https://www.tubechop.com/</a></p>
	<p><a href="https://watchkin.com/">https://watchkin.com/</a></p>
<p><i>BURIME MEDIATIKE</i></p>	
	<p><b>RTE Home School Hub</b> - "Shkolla në shtëpi" me orë dhe aktivitete, por edhe me fletë pune të gatshme.</p>

## 5. KONKLUZIONE

Nëse marrim parasysh të gjitha segmentet e përfshira në këtë analizë, është padyshim perceptimi që në fillim të krizës për shkak të Covid-19<sup>48</sup> Mësimi në distancë në Republikën e Maqedonisë së Veriut u zhvillua me shumë mangësi, të cilat nga ana tjetër reflektuan në cilësinë e mësimdhënies dhe cilësinë e njohurive të fituara. Përkatësisht, mangësitë janë më të dukshme në kornizën ligjore joadekuate që nuk mund ta mbaj hapin me sfidat moderne (në thelb, korniza ekzistuese ligjore nuk parashikon termin "mësim në distancë"), atëherë në mungesën e infrastrukturës për mësimin në distancë (të gjithë palët e interesuara nuk kanë një stabilitet internet dhe pajisje të mjaftueshme të nevojshme për të monitoruar procesin e mësimdhënies), në kapacitetet joadekuate në sektorin e arsimit (një numër i madh mësuesish janë të papërvojë dhe pa trajnim adekuat për situatën aktuale), në aftësitë teknike joadekuate, si dhe në ndihmën dhe organizimin e pamjaftueshëm të të gjithë procesit, e cila është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e institucioneve shtetërore kompetente. E gjithë kjo rezultoi në zbatim të pamjaftueshëm të mësimdhënies reale dykahëshe, me kohë të pamjaftueshme të shpenzuar në mësim dhe rrjedhimisht me vlerësimin jorealit, megjithëse mësuesit thonë se ata janë "pjesërisht të kënaqur" me rezultatin përfundimtar, e pas së gjitha të metave të vërejtura.

Rishikimi i kornizës ligjore në lidhje me procesin arsimor (ligjet dhe aktet nënligjore) tregon mangësitë organizative dhe boshllëqet ligjore, korniza ligjore ekzistuese nuk parashikon mësim në distancë dhe për këtë arsye nuk e rregullon atë. Për më tepër, boshllëqet ligjore nuk adresohen sa duhet edhe nga urdhëresat me fuqi ligjore si mjete të jashtëzakonshme ligjore, të cilat me tepër janë dokumente teknike dhe nuk përmbajnë rregulla/dispozita thelbësore. Urdhëresat, të kuptuara si lloj udhëzimesh, nuk janë përpiluar me rregulla dhe standarde për çdo nivel arsimit dhe në fakt, në një mënyrë të tillë do të mundësohej zhvillim cilësor dhe i kontrolluar i procesit arsimor në një situatë krize, e cila padyshim që kërkon një udhëheqje më specifike të centralizuar.

Gjithsesi, këto mangësi duhet të rregullohen ligjërisht duke pasur parasysh situatën e pasigurt që rrethon përhapjen e pandemisë, por edhe për shkak të probabilitetit të lartë që viti akademik 2020/2021 të vazhdojë në mënyrë të ngjashme ose në mënyrë të njëjtë. Është e nevojshme të merren në konsideratë opsionet e ndryshme dhe artikulohen në mënyrë juridike. Kjo është e domosdoshme, jo vetëm se në të ardhmen sistemi duhet

<sup>48</sup> Konkretisht në periudhën nga marsi deri në qershor 2020.



të jetë i gatshëm për situata të tilla ose të ngjashme, por edhe t'i përgjigjet nevojave moderne arsimore në të cilat mësimi në distancë është tashmë pjesë integrale e sistemit (megjithëse deri më tani te ne as që njihet si opsion arsimor). E gjithë kjo i referohet ndryshimeve të mundshme të ardhshme në zgjidhjet themelore ligjore, si dhe e ndryshimeve në të gjitha aktet nënligjore që dalin prej tyre. Në zgjidhjet e ardhshme ligjore, mësimi në distancë duhet të përcaktohet si një sistem i ri i të mësuarit, si një metodë bazë, shtesë ose alternative. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për t'iu përgjigjur krizës aktuale, por edhe për ta lëvizur dhe modernizuar procesin arsimor në mënyrë që të prodhojë një kuadër konkurrues në tregjet evropiane. Arsimi modern dhe digjitalizimi i tij duhet t'i përgjigjen nevojave moderne të shoqërisë dhe të inkurajojnë zhvillimin e saj.

Padyshim, në të gjithë enigmën analitike, aspekti që mbulon qëndrimet e prindërve në lidhje me njohuritë që fëmijët kanë fituar përmes mësimin në distancë është gjithashtu i rëndësishëm, por ai aspekt duhet të lexohet më së shumti si një sublimat i përvojave të rëndësishme personale/familjare, e pikëpamjeve subjektive mbi situatën e papritur shoqërore të sapo krijuar, aspekte që vijnë veçanërisht në shprehje kur pas një analize të thelluar ato do të krahasohen me të dhënat objektive të marra nga arsimtarët. Në përgjithësi, kuadri mësimdhënës nuk ishte i përgatitur për rrethanat e jashtëzakonshme të procesit arsimor, nuk mori ndihmë institucionale adekuate dhe në kohë, përkatësisht procesi mësimor nuk ishte i centralizuar, por secila shkollë u adaptua për ta përfunduar disi vitin shkollor. Me fjalë të tjera, nuk kishte asnjë qasje sistematike të nevojshme për funksionalitetin e procesit aktual të arsimit të centralizuar në RMV.

Rishikimi i politikave të bashkangjitura tregon se në Republikën e Kroacisë është zbatuar një model i centralizuar i mësimin në distancë, ndryshe nga dy modelet e tjera të analizuara, ato të Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Irlandës. Në modelin kroat, mësimi është i organizuar në nivelin qendror në internet dhe në televizion. Udhëzimet janë përgatitur në mënyrë të hollësishme për organizimin dhe kryerjen e orëve, për vlerësimin dhe për vetëvlerësimin e stafit mësimor dhe nxënësve. Të gjitha materialet e nevojshme janë të disponueshme si shtojca të veçanta, ndërkaq procesi është i rrjetëzuar dhe mbështetet nga institucionet përkatëse kompetente. Mbështetja teknike zbatohet në nivelin kombëtar, me ndihmën e plotë si të Radios dhe Televizionit Kroat (shërbimi kombëtar i medias publike) ashtu edhe i operatorëve mobil kombëtar. Një qasje e tillë e centralizuar mund të jetë model i përshtatshëm për zbatim në sistemin tonë arsimor.

Në Mbretërinë e Bashkuar, theksi është në kapërcimin e ndryshimeve shoqërore, si dhe në mbështetjen psikologjike të nevojshme në një situatë të përgjithshme pasigurie, me theks në rolet e familjes/prindërve dhe ndihmën nga komuniteti lokal. Në situatën e sapo krijuar arsimore, këshillat janë kryesisht mbi baza psikologjike, autoritetet arsimore kryesisht tregojnë se si të merren me grupe të ndryshme moshe të nxënësve, duke udhëzuar në materiale arsimore të përshtatshme që mund të përdoren përveç planit mësimor bazë

që secila prej shkollave e siguron atë në mënyrë të pavarur dhe brenda fushës së detyrimit të tyre të punës. Në këtë kuptim, roli i bashkësisë lokale në ofrimin e ndihmës teknike dhe në organizimin e të gjithë procesit të arsimit në distancë është jashtëzakonisht i rëndësishëm, diçka që në vendin tonë në përgjithësi u trajtua si e një rëndësie dytësore.

Modeli i Republikës së Irlandës është me shumë materiale interesante arsimore, shembuj praktikë, libra shkollorë, libra elektronikë, kuize, materiale mësimore video dhe platforma elektronike të zbatueshme në mjedise të ndryshme arsimore. Stafit mësimdhënës i jepet mundësia të zgjedhë dhe përshtatë mësimin sipas nevojave të tyre. Sidoqoftë, të gjitha materialet janë sublimuar, të disponueshme nga një faqe e rrjetit dhe ofrohet ndihmë teknike në zbatimin e secilës prej qasjeve të zgjedhura. Me përparësinë e një organizimi të mirë, kjo përvojë tregohet të jetë e realizueshme në procesin tonë arsimor, prandaj së këndejmi vlerësojmë që duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë përmes analizave më të hollësishme për t'i rishikuar detajet dhe mundësitë për zbatimin e saj specifik në të gjitha nivelet e arsimit.

## REKOMANDIME

Bazuar në analizën e kryer, nga përvojat krahasuese, si dhe nga përgjigjet e marra nga kuadri arsimor i përfshirë në fokus grupe, pastaj nga pikëpamjet dhe mendimet e të anketuarve në lidhje me sfidat e procesit të quajtur "mësimi në distancë në Republikën e Maqedonisë së Veriut", si hapa në drejtim të përmirësimit, i veçojmë rekomandimet e mëposhtme.

### *Kuadri ligjor*

Është e nevojshme të përcaktohen mënyra të organizimit të funksionimit të mësimin nga distanca dhe ato elemente të pasqyrohen në kornizën ligjore. Kështu, ligjet sistemike që rregullojnë arsimin duhet së pari të njohin mundësinë e këtij lloji të mësimdhënies, dhe më tej ta pranojnë atë si një metodë të vlefshme të arsimit.

Përveç kësaj, mënyrat e kryerjes së mësimin në distancë, organizimi i tij, si dhe vlerësimi gjatë mësimin në distancë, duhet të shtjellohen më tej në aktet nënligjore që do të kenë fleksibilitetin e duhur për t'i rregulluar situatat që shpesh janë subjekt i ndryshimit (siç është rasti me arsimin digjital).

Prandaj, ne propozojmë krijimin e zgjidhjeve përmes normave kornizë dhe konsiderojmë se zgjidhjet e ngurta nuk janë të përshtatshme. Propozojmë krijimin e standardeve të përshtatura për secilin nivel të arsimit, si dhe përpunimin shtesë të tyre me akte nënligjore.

### *Parakushtet teknike për mësimin në distancë*

Është e dëshirueshme që të ketë një platformë të vetme mësimore në internet që do të përdoret nga të gjitha shkollat. Duke qenë se shteti tashmë është vonë në krijimin e një platforme të tillë arsimore, ne rekomandojmë krijimin e një baze të gjerë të dhënash të burimeve elektronike, duke siguruar qasje në një larmi materiale elektronike që mësuesit mund të përdorin në varësi të planeve dhe programeve të tyre specifike të punës.

Do të jetë e dobishme për mësuesit që të kenë platformë për shkëmbimin e përvojave dhe materialeve në të njëjtat lëndë/klasa.

Duke ndjekur shembullin e Republikës së Kroacisë, ne propozojmë sa më shumë që të jetë e mundur të përdoren të ashtuquajturat "TV Klasa" që do të ndjekin programet e vendosura në platformën e përbashkët.

Është e nevojshme që secili student të pajiset me pajisje të përshtatshme dhe qasje në internet në mënyrë që të jetë në gjendje të angazhohet në mësim. Prioritet duhet t'u jepet nxënësve të kategorive të rrezikuara. Në këtë proces duhet të përfshihet edhe vetëqeverisja lokale.

Për sa u përket mësuesve, shkollat dhe institucionet e tjera kompetente duhet t'u sigurojnë atyre kushte për kryerjen e mësimit në distancë. Institucionet gjithashtu janë të detyruara të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për mësuesit për të gjitha situatat dhe sfidat e mundshme. Ne sugjerojmë që mësuesit të mbajnë orët në klasat e tyre ku ata kanë të gjitha mjetet didaktike dhe shkolla do tu siguronte lidhje interneti dhe ndihmë teknike.

Për më tepër dhe në mënyrë të pavarur nga kriza aktuale, duhet të bëhet digjitalizimi i plotë i procesit arsimor (ditari elektronik, notat elektronike, detyrat-e të shtëpisë).

Publikimi i librave shkollore në formë elektronike është një parakusht për mësimin në distancë, prandaj Ministria e Arsimit dhe Shkencës urgjentisht duhet të gjejë mënyrë për t'i marrë përsipër të drejtat e autorit.

### *Arsimi digjital*

Gjatë procesit arsimor, nxënësit duhet të pajisen me aftësitë e duhura për TIK. Shteti nuk ka masa të mjaftueshme për të forcuar arsimin digjital të popullsisë, që është i nevojshëm për të gjitha aktivitetet profesionale në shekullin 21, jo vetëm për pjesëmarrjen në mësimin në distancë.

Për të përdorur momentin aktual të krizës për ndërtimin aktiv të aftësive digjitale tek nxënësit, të cilët nesër do të jenë qytetarë të përgatitur në mënyrë digjitale në një shoqëri moderne. Propozojmë intensifikimin e orëve dhe mësimdhënien për TIK, punën në kompjuter dhe programim, ose krejtësisht si të reja ose në vend të kurseve që janë ofruar si zgjedhje deri më tani.

Mësuesit duhet urgjentisht të trajnohen në përdorimin e teknologjive të reja në procesin arsimor. Kjo nuk kërkon shumë kohë dhe është një nga parakushtet kryesore për kryerjen e mësimit në distancë, por edhe për modernizimin e mënyrës së punës në përgjithësi. Arsimi digjital i mësuesve mund të forcohet përmes përfshirjes në programin mësimor të Fakultetit të Pedagogjisë, por edhe trajnimeve të rregullta për mësuesit, madje mund të përfshihen si parakusht për punësim ose ngritje në detyrë.

Ndihma teknike është e nevojshme edhe për prindërit, si një mënyrë për ta rritur edhe arsimin digjital të prindërve. Kjo mund të arrihet përmes programeve të hapura falas duke përdorur mjete digjitale që do të ishin në dispozicion për të gjithë qytetarët në internet dhe në televizion.

### *Mënyra e zhvillimit të mësimin në distancë*

Për kuadrin mësimdhënës dhe nxënësit, përkatësisht për grup moshat e ndryshme, të përgatiten rekomandime të përshtatshme për mësimin në distancë. Sidomos prindërit e fëmijëve të përfshirë në arsimin fillor të njihen me procesin e përgjithshëm dhe të përfshihen aktivisht në të. Kjo është e rëndësishme sepse fëmijët deri në (përafërsisht) moshën nëntë vjeç janë të pafuqishëm pa prindërit e tyre dhe duhet të kenë mbështetje.

Klasat e regjistruara dhe orët që do të zhvillohen me prani fizike ose në distancë duhet të ndjekin të njëjtat plane mësimore dhe materiale, pra nuk duhet të ketë probleme nëse nxënësit individualisht ose në grupe transferohen nga një mënyrë e të mësuarit në një tjetër. Duhet dhënë përparësi mësimdhënies në distancë ku mësuesit do të punojnë nga shkollat.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara nevojiten rregulla/manuale të veçanta për mësimin në distancë.

Nevojiten rekomandime për të vendosur metoda efektive për vlerësim.

### *Programe mësimore*

Është veçanërisht e rëndësishme në vitin e ri shkollor të përsëritet materiali mësimor i mësuar nga marsi deri në qershor 2020.

Duhet domosdoshmërisht të modernizohet përmbajtja mësimore, përkatësisht theksi duhet të vihet në zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësit, të zbatueshme në secilën lëndë.

Të përshtaten programe mësimore, pra të krijohen programe të adaptueshme për mësimin në distancë.

Gjatë mësimin në distancë, gjatësia e orës duhet të përshtatet me lëndën dhe moshën e nxënësve.

Të krijohen programe mësimore digjitale për fëmijët me nevoja të veçanta, përkatësisht për ta është e nevojshme të vendosen mundësi alternative të të nxënët.

### *Koordinimi*

Duke pasur parasysh që procesi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është jashtëzakonisht i centralizuar, në një situatë krize është e nevojshme të forcohet roli koordinues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe Byrosë së Arsimit dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të përfshihen drejtpërdrejt në proces.

Për mësimin në distancë nevojiten udhëzime dhe mbështetje e drejtpërdrejtë për mësuesit. Udhëzimet duhet të formulohen si udhëzime dhe standarde, ndërkaq nevojitet edhe ndihmë e duhur për zbatimin e tyre.

Nevojitet një qasje në kohë, serioze dhe efektive nga të gjitha institucionet përkatëse. Nevojitet vendosja e infrastrukturës digjitale, pajisje për secilën nga palët e përfshira në proces që nuk janë në gjendje t'i sigurojnë vetë. Kjo mund të adresohet me prokurimin publik, por edhe me thirrje për donacione nga të gjitha kompanitë dhe institucionet publike për pajisje të përdorshme, gjatë çka përparësi do tu jepet nxënësve që janë pjesë e kategorive të rrezikuara. Internet - kuponët janë hap i shkëlqyeshëm, por është e dëshirueshme që shteti të subvencionojë internetin e plotë të destinuar për ndarjen e përmbajtjes arsimore (një shembull që haset në disa vende).

Është e nevojshme të krijohet baza e të dhënave dhe e leksioneve, si dhe materiale elektronike që mësuesit do të jenë në gjendje të shkëmbejnë dhe të përdorin. Është e rëndësishme të sigurohet qasja në bibliotekat e shumta elektronike (edhe pse gjatë pandemisë shumë prej tyre siguruan qasje falas në dokumentet e tyre).

Në të ardhmen, është e nevojshme të vendoset model i centralizuar, platformë e unifikuar për mësim. Por duke qenë se prokurimi i një platforme të tillë është i ndërlikuar dhe i kushtueshëm, duhet kohë për tu zhvilluar dhe funksionalizuar (siç propozohet në Konceptin për zhvillimin e sistemit për mësim në distancë në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut).<sup>49</sup> Sugjerojmë si hap të parë, që çdo shkollë të zgjedhë platformën e saj të të mësuarit nga ekzistueset. Ndryshe nga zgjedhja e platformës, materialet dhe burimet duhet të përgatiten në mënyrë të centralizuar dhe sistematizuar, ndërsa mbështetja gjithashtu duhet të sigurohet në mënyrë qendrore.

Nevojitet një përpjekje e koordinuar që stafi mësimdhënës të trajnohet për përdorimin e teknologjisë informatike dhe tu sigurohet asistencë teknike në çdo kohë. Personeli mësimdhënës ka nevojë për mbështetjen më të madhe sepse ky grup mbart barrën më të madhe të ndryshimeve.

Duhen zgjidhje urgjente dhe mobilizim nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, që çdo fëmijë të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të pakontestueshme për arsimim. Prandaj, mbi të gjitha, ne apelojmë të miratohen masa afatshkurtra që do të mundësojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies që nga fillimi i vitit të ri shkollor. Dokumentet formale strategjike nuk janë aq të nevojshme, por nevojiten standarde specifike për mësimin në distancë dhe udhëzime praktike për mësuesit.

Ekziston nevoja për komunikim më të madh të ekipit profesional të shkollave me të gjithë aktorët në procesin arsimor, veçanërisht me prindërit, duke pasur parasysh që jo të gjithë janë në gjendje të ofrojnë ndihmën e nevojshme për fëmijët. Është e nevojshme

<sup>49</sup> Dokumenti u botua në korrik 2020 në <http://mon.gov.mk/content/?id=3262>.

të zhvillohen udhëzime specifike për prindërit në mënyrë që ata të mund të sigurojnë mbështetjen e nevojshme arsimore dhe psikologjike. Qasja juaj duhet të përfshijë padyshim udhëzime që nxënësit të pranojnë mësimin në distancë, të cilat do t'u transmetohet atyre nga mësuesit dhe prindërit.

Shpresojmë që nga rekomandimet e bashkëngjitura dhe përvojat e paraqitura të nxjerrim shembuj pozitivë që mund të zbatohen në organizimin e ardhshëm të mësimin në distancë në vendin tonë. Qëllimi është të përmirësohen politikat publike dhe shërbimet publike për të mirën e qytetarëve. Prandaj, është e rëndësishme që të mobilizohen të gjitha kapacitetet në dispozicion për përgatitjen serioze të mësimdhënies dhe organizimin e tij të suksesshëm në të ardhmen.













Rr. "Rajko Zhinzifov" nr. 44/1 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë Së Veriut  
tel.: +389 (0) 2 6092-216  
info@cup.org.mk  
www.cup.org.mk



*Citizens for change!*



QENDRA PËR  
MENAXHIM ME  
NDRYSHIME

Projekti është mbështetur nga  
Bashkimi Evropian